



AKTUALE



LIMAJ: KOSOVA DO TA KETË NJË ZË UNIK NË DIALOGUN ME SERBINË F. 2

89 GJOBA PËR NDOTËSIT VETËM GJATË MUAJIT NËNTOR F. 6

QEVERIA MIRATON PROJEKTLIGJIN PËR DELEGACIONIN SHTETËROR TË DIALOGUT F. 7

EKONOMI

GUVERNATORI MEHMETI: VITI 2018 ISHTE ME ZHVILLIME POZITIVE NË SEKTORIN FINANCIAR F. 9

RUKIQI: RITJA EKONOMIKE 4.2 PËR QIND NUK ËSHTË E QËNDRUESHME F. 9

KULTURË

MUZEU KOMBËTAR I KOSOVËS NDRYSHON STATUTIN E 1978-S F. 13



SPORT

1 000 MIJË EURO PAGË MUJORE PËR FAMILJEN E FADIL VOKRRIT F. 16

FLET PËR "EPOKËN E RE", MEVLUDIN KRASNIQI F. 4-5

Taksa 100 % rriti konsumin e produkteve vendore

Zëvendësministri në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi, ka bërë me dije se për vitin 2019 nga buxheti i kësaj ministrie prej 61.4 milionë eurosh, bujqësia do të mbështetet përmes subvencioneve në vlerë prej 24.9 milionë eurosh si dhe përmes granteve investive në vlerë prej 25.7 milionë eurosh. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo ministri në programet e veta zhvillimore edhe për vitin e ardhshëm ka planifikuar masa të shumta përkrahëse për fermerët, agrobizneset, industrinë përpunuese ushqimore, përmes të cilave synon rritjen e prodhimit të vendore. Duke folur për taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës, Krasniqi ka thënë se kjo taksë ka rritur konsumin e produkteve të prodhuara në Kosovë

Presidenti Thaçi kërkon rritjen e pagave për ushtarët e FSK-së

Presidenti i vendit, njëherësh komandant suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Hashim Thaçi, i ka propozuar Qeverisë rritjen e pagave për ushtarët e FSK-së. Ai ka thënë se ky propozim po bëhet me qëllim që ushtarët e Kosovës të kenë paga dhe një jetë më të dinjitetshme. Këto komente presidenti Thaçi i ka bërë të hënën gjatë një drekë të përbashkët me ushtarët e FSK-së në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë



Barazi
Drejtësi
Zhvillim

VETËVENDOSJEI

Selimi numëron skandalet e vitit 2018 në institucionet e sigurisë F. 6

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Limaj: Kosova do ta ketë një zë unik në dialogun me Serbinë

Bashkëdrejtuesi i delegacionit shtetëror të Kosovës në dialog me Serbinë, Fatmir Limaj, ka thënë të hënën se Kosova do ta ketë një zë unik dhe një platformë të përbashkët në këtë proces. "Po shkojmë drejt unifikimit të fuqizimit dhe një adrese të fuqishme, e cila do të jetë e gatshme për të negociuar një marrëveshje finale të mundshme me Serbinë", ka shtuar Limaj pas takimit të dytë të këtij delegacioni

"Epoka e re"

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Delegacioni shtetëror për dialog me Serbinë ka mbajtur të hënën mbledhjen e dytë. Pas këtij takimi, bashkëdrejtuesi i delegacionit shtetëror, Fatmir Limaj, ka thënë se në takim janë njoftuar anëtarët e delegacionit me takimet që ai dhe Shpend Ahmeti kanë pasur me krerët e shtetit dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë. Limaj ka thënë se delegacioni është njoftuar edhe me një raport të shkurtër të Komisionit i cili po bën draftplatformën për bisedime. Sipas Limajt, presidenti i vendit, kryeministri dhe kryeparlamentari kanë ofruar mbështetjen e plotë për delegacionin. "Presidenti dhe kryeministri do ta furnizojnë delegacionin shtetëror me të gjithë ato tema që janë diskutuar deri më tani. Në ditët në vazhdim do të

marrim gjithë dokumentacionin dhe temat që janë trajtuar dhe dalëngadalë delegacioni do t'i trajtojë", ka thënë Limaj pas takimit. Ai ka thënë se në dhjetëditëshin e parë të muajit janar delegacioni do të udhëtojë për Bruksel me ftesë të BE-së. Sipas Limajt, delegacioni shtetëror po bën përpjekje për t'i koordinuar aktivitetet institucionale. Ai ka thënë se Kosova do ta ketë një zë unik dhe një platformë të përbashkët dhe për këtë, sipas tij, sinjalet janë pozitive. "Po shkojmë drejt unifikimit të fuqizimit dhe një adrese të fuqishme, e cila do të jetë e gatshme për të negociuar një marrëveshje finale të mundshme me Serbinë", ka shtuar Limaj. I pyetur se cilat tema do të ngrehën nga pala e Kosovës, Limaj ka thënë se janë rreth 12 tema të cilat janë në interes të Kosovës: Siç janë të zhdukurit, temat ekonomike, pronat dhe tema të tjera.



Presidenti Thaçi takoi kryesuesit e ekipit negociator

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën ka pritur në takim kryesuesit e ekipit negociator të Kosovës, Fatmir Limajn dhe Shpend Ahmetin. Presidenti Thaçi ka biseduar me kryesuesit e ekipit negociator për fazën e fundit të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian dhe të mbështetur

fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Presidenti Thaçi me bartësit e ekipit negociator të Kosovës kanë biseduar edhe për domosdoshmërinë e vazhdimit të koordinimit përgjatë procesit të bisedimeve dhe për shfrytëzimin e momentumit për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare gjithëpërfshirëse dhe ligjërish të obligueshme, e cila Kosovës duhet t'i sigurojë njohjen nga

Serbia dhe anëtarësimin në OKB, NATO dhe BE. Ky momentum duhet shfrytëzuar dhe është e nevojshme të forcohet edhe më shumë uniteti politik dhe të flitet me një zë për Kosovën. Kjo ishte edhe kërkesa e qartë e presidentit Trump për leadershipin e Kosovës, të cilën duhet ta respektojmë, sepse është në përputhje të plotë me interesin tonë shtetëror.

Rama mban në ankth qeverinë

TIRANË, 24 DHJETOR - Pas më shumë se pesë orësh, Edi Rama i dha fund mbledhjes së kryesisë socialiste që ka zgjatuar më shumë që kur ai drejton partinë. Një analizë e partisë dhe e qeverisjes, në përfundim të së cilës kryeministri foli për vetëkorrigjim. "Çdo ditë ka gjëra për t'u korrigjuar sepse nuk jemi të pagabueshëm. Në vakuumin e madh të një opozite të besueshme, na duhet të vetëkorrigjohemi", tha Rama. Shuplaka që Rama thotë se i dha qeverisë protesta e studentëve, ka



qenë gjithashtu pjesë e analizës. Burimet tregojnë se kryeministri është shprehur i pakënaqur me Forumin Rinor të PS-së që, sipas tij, nuk ka sinjalizuar për masivizimin e pakënaqësisë. "Protesta ka

trajektoren e vet, reflektimi ynë është i domosdoshëm pas asaj shuplake dhe do të vazhdojë e do të thellohet në funksion jo vetëm të studentëve, por edhe në funksion të të qenit në lartësinë e ambicieve, por edhe shqetësimeve të shoqërisë", theksoi kreu i qeverisë. Kryeministri duket i ndërgjegjshëm se problemet e qeverisë së tij shkojnë përtej studentëve dhe pranon se ka shumë për të korrigjuar. "Ne e kuptojmë që ka ende shumë për të bërë dhe,

pavarësisht prej rezultateve të padiskutueshme që janë arritur, njerëzit meritojnë shumë më tepër. Në këtë aspekt kemi shumë për të korrigjuar, kemi bërë gabimet tona, gabime që i bëjnë të gjithë ata që ndërtojnë dhe punojnë", tha ai. A do të bëjë kryeministri ndryshime në qeveri në kuadër të këtij reflektimi? "Çdo gjë hap pas hapi, ju e dini se unë nuk e them asnjëherë fjalën e fundit të parën dhe unë di gjithmonë radhën e lëvizjeve, pasi

g gjithmonë mendohem gjatë para se të bëj çdo lëvizje", u përgjigj Rama. Lëvizja e radhës është të premten, më 28 dhjetor, në orën 10:00, kur socialistët kanë thirrur Asamblenë. Këtu pritet që Rama të shprehet përfundimisht nëse do ta rifreskojë ekipin me të cilin drejton vendin apo ta presë pranverën, kur në mars kryesia e PS-së vendosi ta thërrasë Kongresin paraelektoral që do ta dërgojë partinë në zgjedhjet vendore të qershorit 2019.

Kryemadhi: PS-në nuk e drejtojnë socialistët, por kriminelët

TIRANË, 24 DHJETOR - Kryetarja e Lëvizjes socialiste për Integritet, Monika Kryemadhi, gjatë takimit me strukturat e LSI-së në Mallakastër, u ka bërë sërish thirrje qytetarëve të mos braktisin studentët. Ajo ka ripërsëritur

edhe një herë thirrjen që të gjithë t'i harrojnë kartat e anëtarësisë dhe të luftojnë për flamurin kombëtar të marrë peng nga krimi. "Edhe pse jemi në prag festash, në Shqipëri nuk flitet për tryeza plot, por për tryeza bosh.

Këtu është thënë që do të ulet TVSh-ja për energjinë, por nuk është ulet. U premtua se do të ulet TVSh-ja për shportën e ushqimeve, sërish nuk është ulet. Ne shohim një mungesë përgjegjësie të qeverisë. Ka

ardhur koha që ta quajmë Shqipërinë si shtëpinë tonë, pasi çdo shqiptar vendin e vet e ka në Shqipëri", tha kryetarja e LSI-së. Kryemadhi tha se abuzimet e qeverisë vetëm sa shtohen, ndërsa shqiptarët janë më të varfër.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën ka drekuar me ushtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK)

Presidenti Thaçi kërkon rritjen e pagave për ushtarët e FSK-së

Presidenti i vendit, njëherësh komandant suprem i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Hashim Thaçi, i ka propozuar Qeverisë rritjen e pagave për ushtarët e FSK-së. Ai ka thënë se ky propozim po bëhet me qëllim që ushtarët e Kosovës të kenë paga dhe jetë më të dinjitetshme. Këto komente presidenti Thaçi i ka bërë të hënën në një drekë të përbashkët me ushtarët e FSK-së në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj është zotuar se Qeveria do ta mbështesë propozimin e presidentit për rritjen e pagave për ushtarët e Kosovës

**EPOKA
ERE****Shqipe HETEMI**

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që t'i rrisë pagat e ushtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Këtë propozim i pari i vendit dhe komandanti suprem i FSK-së e ka bërë të hënën në një drekë të përbashkët me gjeneralëjtënant Rrahman Rama dhe ushtarët e FSK-së në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë. "Tash pasi që kemi themeluar ushtrinë, të gjithë kemi një unanimitet të plotë të mbështetjes së ushtrisë së Kosovës, të zhvillimit të saj dhe të realizimit të qëllimit

e misionit të tyre. Unë kam vendosur si president dhe komandant suprem i ushtrisë së Kosovës t'i propozoj Qeverisë së Kosovës rritjen e pagave për ushtarët e FSK-së në mënyrë që ata të kenë një jetë të dinjitetshme, një pagë të dinjitetshme në punën dhe angazhimin e tyre. Shpresoj se Qeveria e Kosovës do t'i përgjigjet pozitivisht thirrjes dhe kërkesës sime për rritjen e pagave në mënyrë solide dhe të pranueshme. Kam besim të plotë se të gjitha institucionet, Presidenca, Kuvendi dhe Qeveria do të jemi të mobilizuar pa dalim edhe në këtë drejtim", ka deklaruar Thaçi.

Ai ka bërë me dije se ende nuk ka

ardhur në zyrën e tij pakoja ligjore për transformimin e FSK-së, por Thaçi ka thënë se atë ditë që t'i shkojnë ligjet do t'i nënshkruajë. Presidenti Thaçi ka thënë se ushtria e Kosovës do të jetë ushtri e paqes dhe e stabilitetit nëpër vende të ndryshme të botës. Ai ka shprehur optimizëm se në një të ardhme jo të largët ushtarët e Kosovës dhe ata të Serbisë do të shërbejnë së bashku në misione paqeruajtëse. "Kisha kënaqësinë që së bashku me gjeneralin Rama dhe ushtarët e Kosovës të kemi një drekë të përbashkët dhe puna më e mirë që të ndodhë kjo është pas kthimit nga seanca e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ku edhe një herë u verifikua edhe botërisht mbështetja e miqve dhe partnerëve tanë. Ndihej shumë krenar kur kam qenë luftëtar i lirisë, në kushtet dhe rrethanat që i kemi pasur jo të lehta. Ajo periudhë më jep dinjitet, integritet e krenari që si president i Kosovës për ta vazhduar misionin e ri, atë të fuqizimit të ushtrisë së Kosovës, që të jetë ushtri e paqes, e stabilitetit nëpër vende të ndryshme të botës duke kultivuar paqen së bashku me partnerët e tjerë. Shpresoj që në të ardhmen jo të largët ushtari i Kosovës dhe i Serbisë do të shërbejnë së bashku në misione paqeruajtëse ndërkombëtare", ka theksuar ai.

Ndërsa duke folur për balafaqimin me presidentin serb në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, ai ka thënë se është fakt i pamohueshëm dhe i ditur botërisht se Serbia ka kryer spastrim etnik në Kosovë në përmasa të gjenocidit. Thaçi ka thënë se Serbia herët apo vonë do të përgjigjet për krimet që i ka bërë në Kosovë. "Derisa Serbia nuk heziton ta gënjejë botën edhe ne nuk duhet të hezitojmë për të dhënë të vërtetën që Serbia në vitet 1998-1999 në Kosovë ka vrarë mbi 13 500 civil shqiptarë, aparati ushtarak dhe policor i ka

dhunuar rreth 20 mijë gra shqiptare dhe askush nuk është akuzuar dhe dënuar. Janë kryer rreth 400 masakra në mënyrë të organizuar dhe sistematike nga shteti i Serbisë dhe askush nuk është akuzuar e dënuar. Rreth 40 për qind e infrastrukturës së Kosovës është shkatërruar dhe askush nuk është akuzuar e lerë më dënuar. Në Kosovë ka ndodhur spastrim etnik në përmasa të gjenocidit. Atë që e them para kamerave e them edhe në takime të mbyllura. Dhe, atë që e them në takime të mbyllura e them edhe para kamerave", është shprehur Thaçi.

Presidenti i është përgjigjur edhe interesimit të gazetarëve sa i përket iniciativës së kryetarit Agim Bahtiri për bashkimin e

Mitrovicës, duke thënë se vendimi më i qëlluar është funksionimi i qytetit të Mitrovicës si një i vetëm. "E kemi një situatë ligjore të dalë nga plani i Ahtisarit, por kemi edhe realitetin e funksionimit të qytetit në jug dhe veri që nuk është treguar si ide e qëlluar, mirëpo ka qenë një kompromis për të lëvizur në atë kohë drejt pranimit të dokumentit të Ahtisarit. Kam qenë, jam dhe do të mbetem në shërbim të ndërtimit të urave, afrimit të njerëzve dhe një qyteti ku do të funksionojë demokracia qytetare dhe jo ndarja në baza etnike. Natyrisht hijeshia, madhështia dhe vendimi më i qëlluar është funksionimi i qytetit të Mitrovicës si një i vetëm", ka deklaruar Thaçi.



Haradinaj mbështet propozimin për rritjen e pagave të ushtarëve të Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se Qeveria e Kosovës do ta mbështesë propozimin e presidentit Hashim Thaçi për rritjen e pagave për ushtarët e Kosovës. Ai në një konferencë për medie, pas mbledhjes së Qeverisë, ka thënë se asnjëherë nuk ka hezituuar në mbështetje financiare sa i përket sektorit të sigurisë. "Rritjen e pagave për ushtarët e mirëpresim si Qeveri në çdo kohë dhe atë propozim nga secili institucion. Sidomos për çështje të sigurisë asgjë s'kemi kursyer", ka thënë Haradinaj.

Gjimnazi "Cambridge" shpërblen tre nxënësit më kreativë për fundvit

PEJË, 24 DHJETOR (ER) - Pas tri fazave të testimit, janë përzgjedhur nxënësit më kreativë të Gjimnazit "Cambridge" në Pejë, të cilët kanë treguar rezultate më të mira. Nxënësit e përzgjedhur janë: Blerta Dinaj, klasa e VI; Filiza

Ukaj, klasa e IX dhe Andi Tahiri, klasa e IX. "Këta tre nxënës do të qëndrojnë në Tiranë për tre ditë, ku edhe do të trajnohen në qendrën kreative ICTSlab", është bërë me dije në njoftimin për media të Gjimnazit "Cambridge".

"Gjimnazi Cambridge" shpërblen 3 nxënësit më kreativë për fund vit!

Pas tri fazave të testimit, janë përzgjedhur tre nxënësit që kanë treguar rezultat më të mirë. Ata janë:



Filiza Ukaj
Kl. IX



Andi Tahiri
Kl. IX



Blerta Dinaj
Kl. VI

Nxënësit përfitojnë trajnim treditor në ICTSlab në Tiranë.

Flet për "Epokën e re", Mevludin Krasniqi

Taksa 100 % rriti konsum

Zëvendësministri në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi, ka bërë me dije se për vitin 2019 nga buxheti i kësaj ministrie prej 61.4 milionë eurosh, bujqësia do të mbështetet përmes subvencioneve në vlerë prej 24.9 milionë eurosh si dhe përmes granteve investive në vlerë prej 25. 7 milionë eurosh. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se kjo ministri në programet e saj zhvillimore edhe për vitin e ardhshëm ka planifikuar masa të shumta përkrahëse për fermerët, agrobizneset, industrinë përpunuese ushqimore, përmes të cilave synon edhe më tej rritjen e prodhimitarisë vendore. Duke folur për taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës, Krasniqi ka thënë se kjo taksë ka rritur konsumin e produkteve të prodhuara në Kosovë

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Zëvendësministri në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Mevludin Krasniqi, ka thënë se kjo ministri në vitet e fundit e ka përkrahur sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural me subvencione dhe grante investive. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka theksuar se investimet e kësaj ministrie përmes Programit për Pagesa Direkte për vitin 2018 ka arritur vlerën prej 25 milionë eurosh, ndërkaq në kuadër të këtij programi sivjet kanë qenë 25 870 përfitues në sektorë të ndryshëm të bujqësisë. "Ndërkaq përmes Programit të Zhvillimit Rural, gjegjësisht përmes granteve investive, gjatë këtij viti kemi përkrahur mbi 600 projekte të fermerëve dhe agrobizneseve, në vlerë prej 22 milionë eurosh, ku tashmë jemi në fazën e implementimit të këtyre projekteve", ka thënë ai. Zëvendësministri Krasniqi ka shtuar se Qeveria me politikat e saj strategjike ndërsektoriale dhe në harmoni të plotë me politikat e përbashkëta bujqësore të Bashkimit Evropian, është orientuar për rritjen e kapaciteteve të prodhimit dhe për krijimin e kushteve sa më të favorshme për prodhuesit vendorë, duke iu bashkëngjitur trendëve zhvillimore të vendeve të BE-së. Krasniqi ka folur edhe për importin e drithërave. Ai ka thënë se Kosova vazhdon të ketë import të drithërave, përkundër

rritjes së prodhimit vendor në bujqësi ndër vite, ku sivjet rendimenti i grurit ka arritur mbi 250 mijë tonë. "Realisht kushtet klimatike kanë ndikuar në zvogëlimin e rendimentit në krahasim me vitet e tjera paraprake. Këtë vit jemi duke punuar bashkë me fermerët dhe shoqatat e tyre, ekspertët e ndryshëm të kësaj fushe që të rritet rendimenti i prodhimit të grurit. Po ashtu, do të vazhdojë mbështetja e MBPZhR-së përmes subvencioneve, të cilat synojnë të ndikojnë në rritjen e mëtejme të prodhimit të kësaj kulture bujqësore", ka deklaruar Krasniqi.

Duke folur për taksën 100 për qind ndaj produkteve të Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës, Krasniqi ka thënë se kjo taksë ka dhënë rezultatet e veta. "Këtë e tregojnë më së miri edhe të dhënat nga Dogana e Kosovës, por natyrisht kemi edhe shtim të konsumit të produkteve të prodhuara në Kosovë", është shprehur ai.

Zëvendësministri Krasniqi ka thënë se kjo ministri në programet zhvillimore edhe për vitin e ardhshëm ka planifikuar masa të shumta përkrahëse për fermerët, agrobizneset, industrinë përpunuese ushqimore, përmes të cilave synon edhe më tej rritjen e prodhimitarisë vendore. "Produktet tona janë të një cilësie të lartë dhe konkurruese në treg. Shfrytëzoj rastin t'u bëj thirrje qytetarëve të vendit tonë që të konsumojmë sa më shumë produkte 'Made in Kosova'", ka thënë Krasniqi. Ai ka treguar se për vitin 2019 nga buxheti i kësaj ministrie prej 61.4 milionë



eurosh, bujqësia në vendin tonë do të mbështetet përmes subvencioneve në vlerë prej 24.9 milionë eurosh, si dhe përmes granteve investive në vlerë prej 25. 7 milionë eurosh.

"Epoka e re": Z. Krasniqi, sa është shuma e subvencioneve

dhe granteve investive të ndara nga MBPZhR-ja në vitin 2018?

Krasniqi: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural vitet e fundit e ka përkrahur sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural me subvencione dhe grante investive. Investimet e ministrisë përmes Programit për

Pagesa Direkte për vitin 2018 kanë arritur vlerën prej 25 milionë eurosh, ndërkaq në kuadër të këtij programi sivjet kanë qenë 25 870 përfitues në sektorë të ndryshëm të bujqësisë. Ndërkaq përmes Programit të Zhvillimit Rural, gjegjësisht përmes granteve investive, gjatë

in e produkteve vendore



këtij viti kemi përkrahur mbi 600 projekte të fermerëve dhe agrobizneseve në vlerë prej 22 milionë eurosh, ku tashmë jemi në fazën e implementimit të këtyre projekteve. Përmes kësaj mbështetje kemi arritur të ndikojmë në rritjen e prodhimtarisë bujqësore, rritjen e cilësisë

së prodhimeve bujqësore, rritjen e punësimit dhe krijimin e të ardhurave në sektorin agrorshqimor dhe shërbimeve rurale.

"Epoka e re": Sa është shuma e ndarë për drithëra dhe mjedra? Krasniqi: Fillimisht, sipas të

dhënave tona, në vitin 2018 në Kosovë janë mbjellë 83,515.00 hektarë drithëra, prej tyre 74,133.00 hektarë me grurë dhe kultivuesit e drithërave kanë përfituar nga pagesat direkte (subvencionet) nga 150 euro për hektar, gjegjësisht 9.7 milionë euro, prej tyre 150 mijë euro

subvencione kanë qenë për kultivuesit e farës së grurit. Ndërkaq, sa i përket mjedrës, këtë kulturë bashkë me kulturat e tjera të pemëve të imta dhe bimëve mjekësore aromatike, në projektin e përbashkët me USAID-in, MBPZHR-ja e ka financuar me 3 milionë euro.

"Epoka e re": Kosova ka importuar mbi 100 mijë tonelata grurë vetëm në dhjetëmujorin e parë të këtij viti, sipas ASK-së. Pse i gjithë ky import?

Krasniqi: Fatkeqësisht, e dimë se Kosova vazhdon të ketë import të drithërave, përkundër rritjes së prodhimit vendor në bujqësi ndër vite, ku sivjet rendimenti i grurit ka arritur mbi 250 mijë tonë, që realisht kushtet klimatike kanë ndikuar në zvogëlimin e rendimentit në krahasim me vitet e tjera paraprake. Këtë vit jemi duke punuar bashkë me fermerët dhe shoqatat e tyre, ekspertët e ndryshëm të kësaj fushe që të rritet rendimenti i prodhimit të grurit. Po ashtu, do të vazhdojë mbështetja e MBPZHR-së përmes subvencioneve, të cilat synojmë të ndikojnë në rritjen e mëtejme të prodhimit të kësaj kulture bujqësore.

"Epoka e re": Cilat janë kulturat bujqësore me anë të të cilave synoni që në vitin 2019 të rritet pjesëmarrja e eksporteve me kultura bujqësore?

Krasniqi: Ne si Qeveri, me politikat tona strategjike ndërsektoriale dhe në harmoni të plotë me politikat e përbashkëta bujqësore të Bashkimit Evropian, jemi të orientuar për rritjen e kapaciteteve të prodhimit dhe për krijimin e kushteve sa më të favorshme për prodhuesit vendorë, në mënyrë që të arrijmë një zhvillim të qëndrueshëm dhe t'u bashkëngjitemi trendëve zhvillimorë të vendeve të BE-së. Prandaj edhe sivjet përmes programeve zhvillimore synojmë ta rrisim eksportin e produkteve bujqësore, ku përmes granteve investive do t'i mbështesim fermerët dhe prodhuesit vendorë, përfshirë këtu edhe industrinë e përpunimit, pemët e imta dhe bimët mjekësore aromatike, si mundësi reale për rritjen e eksportit të produkteve bujqësore.

"Epoka e re": Masa prej 100 përqindësh për produktet e Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës, a pritet të ndikojë në shtimin e sipërfaqeve të mbjella me grurë nga fermerët kosovarë?

Krasniqi: Unë besoj se tanimë efektet e kësaj mase kanë dhënë rezultatet e veta. Këtë e tregojnë

më së miri edhe të dhënat nga Dogana e Kosovës por, natyrisht, kemi edhe shtim të konsumit të produkteve të prodhuara në Kosovë. Ne si ministri në programet tona zhvillimore edhe për vitin e ardhshëm kemi planifikuar masa të shumta përkrahëse për fermerët, agrobizneset, industrinë përpunuese ushqimore, përmes të cilave synojmë edhe më tej rritjen e prodhimtarisë vendore. Përveç të tjerash, thënë të drejtën, produktet tona janë të një cilësie të lartë dhe konkurruese në treg, ku e shfrytëzoj rastin t'u bëj thirrje qytetarëve të vendit tonë që të konsumojmë sa më shumë produkte "Made in Kosova".

"Epoka e re": Sa ka qenë përkrahja e MBPZHR-së për industrinë e qumështit në vitin 2018?

Krasniqi: Këtë sektor e kemi mbështetur përmes subvencioneve dhe granteve investive. Përmes subvencioneve, sipas cilësisë së qumështit, ku çdo fermer ka përfituar 2, 4 ose 6 cent për litër të prodhuar. Po ashtu, krahas kësaj mbështetje, kemi dhjetëra përfitues të cilët janë përkrahur në projektet e tyre për ndërtimin dhe zhvillimin e fermave, pikave grumbulluese të qumështi, por edhe investime për ngritjen e kapaciteteve prodhuese dhe përpunuese në industrinë e qumështit.

"Epoka e re": Çfarë planesh ka MBZPhR-ja për vitin 2019?

Krasniqi: Me politikat bujqësore zhvillimore, të cilat janë të bazuara në Strategjinë për Zhvillimin e Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural 2014-2020, do ta vazhdojmë mbështetjen e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural edhe në vitin që vjen, duke punuar edhe në drejtime të reja dhe përkrahje të fermerëve. Tashmë jemi në finalizim të Programit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2019 dhe në atë program, përveç masave të aplikuara më herët, do të fusim skema të reja të mbështetjes. Për vitin 2019 nga buxheti i ministrisë prej 61.4 milionë eurosh, bujqësia do të mbështetet përmes subvencioneve prej 24.9 milionë eurosh si dhe përmes granteve investive në vlerë prej 25.7 milionë eurosh. Gjithashtu, do të vazhdojë bashkëpunimi edhe me partnerët ndërkombëtarë, për fuqizimin e mëtejme të sektorit. Meqë jemi te buxheti, vlen të theksohet se brenda kapaciteteve buxhetore do t'i vazhdojmë investimet edhe në sistemin e ujitjes dhe në përmirësimin e infrastrukturës së vreshtave.

Porosia e Imzot Dodë Gjergjit për Krishtlindje 2018

Meshtarëve, rregulltarëve e rregulltareve, vëllezërve e motrave në fe dhe të gjithë njerëzve vullnetmirë!

Të dashur vëllezër e motra, pas një viti kremtimesh intensive, në kuadër të vitit të Gjergji Kastriotit, po vij edhe një herë tek Ju me porosinë time të përvitshme për festën e Krishtlindjes, në këtë kohë shprese dhe gëzimi.

Njeriu, që nga zanafilla, është ndier i braktisur, i vetmuar dhe i humbur në humnerën e mëkatit të vet. Ai është detyruar ta përballojë trishtimin e vetmisë në përballje me vetën, me botën, me mëkatin dhe me vdekjen; po ashtu është detyruar t'i përballojë vuajtjet individuale dhe kolektive gjatë shtegtimit nëpër tokë. Mu për këtë, njeriu kurrë s'ka pushuar duke kërkuar ta rifitojë atë që ka humbur me mëkatin e vet dhe ta rigjejë Krijuesin e tij, që ta ngushëllonte dhe ta shoqëronte në ditët e jetës mbi tokë. Edhe sot, çdo njeri bartë të fshehur në zemrën e vet një dëshirë të mrekullueshme, që ta gjejë personin i cili nuk e gjykon, por e kupton dhe i beson.

Për ne të krishterët, ky person është Foshnja e Betlehemit, Mesia, Biri i Hyjit të gjallë. Ne Atij ia besojmë të gjitha brengat, Atij ia shpalosim të gjitha dëshirat, nëpërmjet uratës ia tregojmë të gjitha fshehtësitë tona, ia rrëfejme mëkatet, ia besojmë jetën dhe vdekjen, e Ai na kupton, na beson, na ngushëllon; asnjëherë nuk befasonet nga dobësitë tona, kurrë nuk na gjykon, gjithnjë na do e na pajton me Atin tonë qiellor.

Kënde, ne Kisha e Tij, s'pusho-



jmë kurrë duke i ftuar të gjithë njerëzit, që të kthehen e të lejojnë që t'i shndrisë Krishti me Shpirtin e Tij të Shenjtë. Dhe atyre që përpiqen ta gjejë, u ndihmon t'i lartësojë sytë drejt dritës që shndritë errësirën e zemrave dhe i aftëson të ecin me gëzim ditëve të jetës. Nën shkëlqimin e kësaj drite dhe shoqërimit të Foshnjës së Betlehemit, çdonjëri prej nesh zbulon në zemrën e vet dëshirën për shenjtërim, dashurinë për çdo njeri dhe arin të gjejë të mirën në tërësinë e gjërave që e rrethojnë, po edhe mëson të bisedojë me të gjithë njerëzit me të cilët e ndanë të përkohshmen. Me lindjen e Krishtit është hapur një proces i ri i dialogut mes Krijuesit dhe krijesës për shpëtimin e tokës dhe njerëzimit. Preambulë e kësaj marrëveshjeje në dialog, mes Mesisë besnik dhe popullit që kërkon dënimin e tij,

mes dashurisë që falë dhe botës që hakmerret dhe mes pushtetit të Pilatit, që gjykon me vdekje në kryq dhe pushtetit të Krishtit, që shpërblen me jetën e pasosur, është Besëlidhja e vjetër. Kurse teksti i marrëveshjes është Ungjilli dhe e tërë Besëlidhja e re. Zbatimi konkret i kësaj marrëveshjeje, të lidhur me Besë, siguron pajtimin përfundimtar ndërmjet Krijuesit dhe krijesës, ndërmjet njeriut dhe Hyjit. Ky dialog dhe kjo marrëveshje i ofrohet çdo njeriu. Ai që e pranon, e nënshkruan në zemrën e vet dhe e lejon Kishën që ta pagëzojë me ujë. Kurse Hyji, të njëjtën marrëveshjeje e nënshkruan me gozhdën e Kryqit dhe me gjakun e të Birit të Tij.

Vëllezër dhe motra, nëse Hyji s'ka pasur frikë të bisedojë me botën, aq më pak

duhet të kemi frikë ne të bisedojmë me njëri-tjetrin, në familje e në shoqëri, ndërmjet familjeve, partive dhe popujve. Dialogu është parakusht i paqes, pajtimit dhe të mirës së përbashkët. Buron nga vullneti i mirë dhe dëshira për të ardhmen më të mirë të të gjithëve. Kënde, askush nuk duhet të ndihet i lodhur nga dialogu dhe askush nuk duhet ta keqpërdorë apo ta mohojë nevojën për të. Dëshiroj që në këto ditë Krishtlindjesh ta ftoj popullin tim shqiptar, kudo që jeton, të jetë i vetëdijshëm se udhëtimi shekullor i popullit tonë drejt kthimit në familjen e popujve të qytetëruar ka qenë tejet i vështirë. Kjo që gëzojmë sot është arritur me mund, djersë dhe gjak të shumë gjeneratave. Kënde, duhet të kihet kujdes që as një dështim yni ose padrejtësi

që na bëhet, të mos e rrezikojë bashkudhëtimin tonë drejt të ardhmes me popujt e Evropës dhe rajonit, sepse e dimë mirë se si kemi pësuar kur kemi gabuar.

Ftoj edhe popujt e Evropës, sido që janë të organizuar në institucionet shoqërore, politike dhe ekonomike, që të jenë më të drejtë dhe të kenë më shumë besim te ne shpatarët. Ne nuk na befason padrejtësia, sepse jemi të mësuar me të, në të kaluarën. Ne sot shpresojmë në drejtësi dhe barazi, në mesin e popujve. Mbi të gjitha, popujt e Evropës nuk duhet ta shohin popullin tim si rrezik, por si trashëgimi kulturore dhe shpirtërore të qytetërimit. Sidomos ftoj popujt e rajonit që të mos thurin plane për të ardhmen duke na përjashtuar neve, por të përpiqen, së bashku me ne, ta arrijmë paqen, të ardhme më të mirë dhe integrim në familjen evropiane.

Në fund, uroj që Krishti, Biri i Hyjit të gjallë, ditëlindjen e të cilit po e kremtojmë, t'i mbushë zemrat Tuaja me dashuri. Ju dhashë forcën për t'i përballuar vështirësitë e jetës dhe padrejtësitë e botës! Ju ngushëlloftë në pikëllim dhe Ju përcjelltë me mëshirë dhe dhembshuri gjatë gjitha ditëve të vitit të ri, që do ta fillojmë një javë më vonë.

Ju garantoj të gjithëve, unë dhe e gjithë kisha, se do t'ju kemi në lutjet tona, do t'ju shërbejmë me përvujtëri dhe dashuri, ashtu si na porositi Foshnja e Betlehemit. Për shumë mot Krishtlindja dhe Viti i Ri 2019!

Ipeshkvi Juaj, DODË GJERGJI

89 gjoba për ndotësit vetëm gjatë muajit nëntor

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Në kuadër të aktiviteteve të fushatës "Ta pastrojmë Kosovën", "Let's Do It" ka bërë monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore nga inspektorët komunalë mjedisorë. Bazuar në të dhënat e monitorimit, rezultojnë se gjatë muajit nëntor në të gjitha komunat e Kosovës janë shqiptuar 89 gjoba mandatore për ndotësit.

Komuna e Prishtinës i prin listës së komunave me më së shumti gjoba të shqiptuara, gjithsej 35, pasuar nga Komuna e Vushtrrisë, inspektorët mjedisorë të së cilës kanë shqiptuar nëntë gjoba. Me

nga shtatë gjoba të shqiptuara lista vazhdon me Komunën e Gjakovës dhe atë të Malishevës, pasuar nga Komuna e Prizrenit me pesë gjoba të shqiptuara për ndotësit, kurse në Komunën e Pejës, të Istogut dhe atë të Obiliqit janë shqiptuar nga katër gjoba për ndotje të mjedisit.

Në Komunën e Vitisë janë shqiptuar vetëm dy gjoba gjatë muajit nëntor, ndërsa tri të tilla kanë qenë në Komunën e Kamenicës. Por, asnjë gjobë nuk është shqiptuar në Rahovec, Fushë-Kosovë, Skenderaj, Podujevë, Mitrovicë, Ferizaj, Kaçanik, Han i Elezit, Klinë, Deçan, Junik, Shtime, Lipjan, Drenas dhe Dragash. Përdërisa në Komunën e Gjilanit dhe atë të Suharekës është shqip-



tuar vetëm nga një gjobë për ndotësit.

Nga të dhënat e monitorimit

rezultojnë se lloji më i shpeshtë i gjobave të shqiptuara ishte ai për hedhjen e mbeturinave dhe

materialeve ndërtimore jashtë vendeve të caktuara. Gjatë monitorimit për muajin nëntor, të kryer nga ekipi i "Let's Do It", rezultojnë se sfidë për zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Gjoba Mandatore vazhdon të mbetet mospajisja e Policisë së Kosovës me tiketa të gjobave mandatore si dhe mungesa e inspektorëve mjedisorë në disa prej komunave.

Udhëzimi Administrativ për Gjoba Mandatore është nënshkruar gjatë fushatës "Ta pastrojmë Kosovën" dhe ka synim reduktimin dhe eliminimin e ndotjes së mjedisit dhe shëndetin e njeriut, mbrojtjen e sipërfaqeve publike dhe private përmes menaxhimit të mbeturinave.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

Qeveria miraton projektligjin për delegacionin shtetëror të dialogut

Projektligji, i cili përcakton detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë, është miratuar të hënën nga kabineti qeveritar. Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se ky projektligj përcakton hierarkinë institucionale dhe procedurën vendimmarrëse në procesin e dialogut dhe nuk ndërhyjnë në kompetencat e presidentit në këtë proces. Sipas tij, projektligji vetëm i jep bazë ligjore funksionimit të këtij delegacioni

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Qeveria e Kosovës ka miratuar të hënën Projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë. Ky projektligj përcakton hierarkinë institucionale dhe procedurën vendimmarrëse në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë në mbledhjen e Qeverisë se me anë të këtij projektligj rregullohet funksionimi i delegacionit dhe struktura e tij. "Po ashtu, ligji rregullon funksionimin e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës për dialogun me Serbinë, duke përcaktuar strukturën organizative, veprimtarinë, kompetencat dhe përgjegjësitë e delegacionit shtetëror. Mes të tjerash, ligji

definon qartë edhe ndërlidhjen që delegacioni shtetëror mban me institucionet e tjera kushtetuese të Republikës së Kosovës", ka thënë Haradinaj. Pas mbledhjes së Qeverisë, në një konferencë për medie, Haradinaj ka bërë me dije se miratimi i këtij ligji nuk ndërhyjnë në kompetencat që ka presidenti i Kosovës në dialog. "Sponsoruesit e ligjit e kanë

menduar këtë si vënie në korniza ligjore të angazhimeve të delegacionit, pra nuk ndërhyjnë në kompetencat të presidentit ligji. Ai vetëm i jep bazë ligjore funksionimit të delegacionit", ka

thënë Haradinaj.

Në mbledhjen e së hënës, kabineti qeveritar ka miratuar edhe katër projektligje të tjera: Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-015 për letërnjoftim; Projektligjin e punës; Projektligjin për pijet e forta alkoolike; si dhe Projektligjin për diasporën. Po ashtu, miratimin e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe plani vjetor i punës së Qeverisë për vitin 2019, i cili shërben për zbatimin e prioriteteve të politikave të përcaktuara në Programin e Punës së Qeverisë së Kosovës. Në mënyrë më specifike aktivitetet prioritare ku do të orientohet puna e Qeverisë gjatë vitit 2019 janë: arsimi, punësimi dhe shëndetësia; qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit; fuqizimi i

konkurrueshmërisë së sektorit privat; infrastruktura dhe mjedis; integrimi evropian, politika e jashtme dhe çështjet e sigurisë. Po ashtu, kabineti qeveritar ka miratuar vendimin që Hajriz Koca të emërohet sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë vendim që të ndërjet Fadil Vokrri t'i njihet statusi i qytetarit me merita të veçanta për kontributin e tij të dhënë në promovimin e sportit në arenën ndërkombëtare. Në mbledhjen e së hënës është miratuar edhe nisma për lidhjen e marrëveshjes për bashkëpunim financiar ushtarak ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Qeveria i ndan 300 mijë euro delegacionit shtetëror për dialogun me Serbinë

Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së hënës ka ndarë 300 mijë euro për delegacionin shtetëror për dialog me Serbinë të drejtuar nga Shpend Ahmeti dhe Fatmir Limaj. Kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë me dije se këto mjete do të ndahen nga rezervat shtetërore. Delegacioni shtetëror do t'i ketë edhe këta anëtarë: Enver Hoxhaj, Avni Arifi, Behgjet Pacolli, Mahir Jaghillar, Dardan Gashi, një përfaqësues nga boshnjakët, një përfaqësues i shoqërisë civile që do të votohet nga ekipi dialogues, ndërkajë dy vende janë të rezervuara për LDK-në dhe IV-në, që tani i mbajnë Visar Ymeri dhe Dukagjin Gorani derisa këto dy subjekte t'i dërgojnë përfaqësuesit e tyre.

Selimi numëron skandalet e vitit 2018 në institucionet e sigurisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Anëtari i Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi, në një konferencë për medie të hënën ka renditur dështimet e institucioneve të sigurisë përgjatë vitit 2018. Selimi ka thënë se kryeskandali i vitit 2018 ishte deportimi i gjashtë shtetasve turq në mënyrë tërësisht joligjore, aspak kushtetuese dhe tepër joprofesionale. "Ndërkohë, AKI-ja është prej institucioneve më të dëmtuarve në imazh dhe në funksion. Në krye të tij u vendos një person i cili do të duhej shkarkuar nga puna e tij në drejtimin e policisë për shkak të skandaleve të shumta aty në vend se t'i besohej drejtimit i një tjetër institucioni të rëndësishëm. Po ashtu, përgjatë vitit një punonjës i AKI-së është vrarë

brenda ambienteve të institucionit, ngjarje kjo për të cilën do të duhej të kishte informacion si për çdo vepër tjetër penale. Inspektorati i Policisë së Kosovës është i dëmtuari i radhës, ngjashëm me AKI-në, përmes vendosjes partiake dhe arbitrare në krye të tij të një personi i cili është kapur në shkelje të ligjit gjatë rekrutimit të oficerëve për këtë institucion", ka thënë Selimi.

Po ashtu, ai ka thënë se Policia e Kosovës ka dështuar të ofrojë siguri, sidomos në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje dhe njëjtë ka dështuar të ofrojë siguri më të madhe edhe në trafik. "Nga ana e saj, Qeveria ka dështuar të ofrojë dy ligje të rëndësishme për sigurinë në vend: draftligjin ngelur pezull ndër vite për pensionimin e parakohshëm në polici dhe plotësimndryshimin për ligjin



për shpëtim dhe zjarrfikje, i cili do të ofronte siguri më të madhe në komunitet dhe i cili do të merrej drejtpërdrejt me gjendjen e rëndë të zjarrfikësve. Zjarrfikësit nga ana e tyre nuk kanë lënë gur pa lëvizur për plotësimin e kërkesave duke

bërë thirrje, peticione dhe protesta", është shprehur Selimi. Më tutje, Selimi ka folur edhe për transformimin e FSK-së në ushtri, duke thënë se Vetëvendosje i ka dhënë mbështetje këtij procesi. "Në projektligjin për buxhetin, FSK-ja

trajtohet njëjtë sikur më herët, përafërsisht me të njëjtin buxhet dhe me të njëjtën dinamikë financiare. Nëse Forcat e Sigurisë së Kosovës trajtohen në atë formë, atëherë do ta kemi shumë të pamundshme realizimin e objektivave që parasheh ndryshimi i tre ligjeve që kanë të bëjnë me FSK-në", është shprehur Selimi. Krejt në fund, Selimi ka thënë se skandalet nuk janë aksidentale në këtë qeveri, por norma e saj e përditshme. "Ndryshimi i shpeshtë i ministrave të punëve të brendshme e ka bërë të pamundur kërkimin e përgjegjësisë dhe etikën profesionale dhe ka stimuluar keqmenaxhimin e institucionit. Kjo qeveri dështimet dhe sabotimet e punëve të institucioneve i shpërblen me ngritje në detyrë. Prandaj duhet ta rrëzojmë për ta filluar rrëzimin e një hierarkie të dhunshme dështimesh", ka thënë Selimi.

Komuna e Malishevës: Shumica e planifikimeve për vitin 2018 janë realizuar

MALISHEVË, 24 DHJETOR (ER) - Këshilli i Drejtorëve në Komunën e Malishevës ka mbajtur të hënën mbledhjen e rregullt, e cila është drejtuar nga nënkryetari i kësaj komune, Hajdin Berisha. Në këtë mbledhje, drejtorët e drejtorive komunale kanë deklaruar se shumica e planifikimeve për vitin 2018 janë realizuar dhe një pjesë e vogël janë në realizim e sipër. Drejtori komunal për Bujqësi, Murat Hoxha, ka raportuar për shpërndarjen e subvencionit

të fundit për bujqit lokalë, me 80 lopë qumështore, ku bëri me dije se Komuna e Malishevës është komuna që më së shumti ka dhënë subvencione për bujqit. Ai ka paralajmëruar edhe për ndarjen edhe të një subvencionit tjetër me spërkatëse 400 litërshe. Në këtë mbledhje të gjithë drejtorët e drejtorive kanë raportuar për realizimin e punëve për javën e kaluar dhe planifikimin për javën në vijim si dhe për aktivitetet e tyre gjatë vitit 2018.




Nis nënshkrimi i petitionit për bashkimin e qytetit të Mitrovicës

MITROVICË, 24 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, së bashku me nënkryetarin Faruk Mujka, të shoqëruar nga drejtorët e drejtorive komunale, kanë nënshkruar të hënën petitionin përmes të cilit kërkohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që ta iniciojë procedurën për ndryshim-plotësimin e Ligjit nr. 03/L-041 për kufijtë administrativë të komunave, me qëllim bashkimin e qytetit të Mitrovicës, por duke mos cenuar në asnjë mënyrë

integritetin territorial të Republikës së Kosovës. Me këtë rast kryetari Bahtiri ka theksuar se nga sot fillon peticioni për bashkimin e Mitrovicës. Ai ka thënë se institucionet lokale kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë që këtë iniciativë ta përmbyllin me bashkim të qytetit. "Kërkoj nga ju që të dalim faqebardhë me këtë peticion, e t'i drejtohem i në mënyrë legjitime Kuvendit të Kosovës. Nuk do të ketë parti politike, por do të jemi ne për të gjithë, peticioni fillon sot dhe në qoftë se dikush do të

ketë hamendje që nuk do të realizohet, gabon sepse do të realizohet. Ju lus si qytetarë të Mitrovicës që t'i dilni zot vendit tuaj, që t'i përgjigjen vullnetarisht dhe masivisht iniciativës sime", ka thënë Bahtiri.

Ky peticion ka shtrirje në tërë Kosovën, me theks të veçantë në Mitrovicë janë vendosur pesë pika, duke filluar para objektit të ndërtesës komunale, te sheshi i qytetit, në afërsi të stacionit të autobusëve, te xhamia "Isa Begu", ku qytetarët kanë mundësi ta nënshkruajnë.



Kastrati me urdhëresë për ndalimin e mjeteve piroteknike

KAMENICË, 24 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka lëshuar urdhëresë për ndalimin e përdorimit të mjeteve piroteknike në vendet publike (rrugë e sheshe), brenda territorit të kësaj komune. Kjo urdhëresë ka hyrë në fuqi më 21 dhjetor dhe vlen

deri më 2 janar 2019.

Kryetari Kastrati ka thënë se vendimi për ndalimin e mjeteve piroteknike është bërë për shkak të sigurisë së qytetarëve në segmentet rrugore publike. "Pas diskutimeve të vazhdueshme me qytetarë ramë dakord që në vendet publike, veçanërisht në

rrugë dhe sheshe, mos të lejohet përdorimi i mjeteve piroteknike për shkak të sigurisë së qytetarëve e fëmijëve", ka thënë Kastrati. Për moszbatimin e këtij vendimi do të shqiptohen gjoba nga 10 deri në 100 euro, është bërë me dije në urdhëresën e lëshuar nga kryetari Kastrati.

Gjashtë shkolla në Kaçanik furnizohen me pajisje dhe material shpenzues

KAÇANIK, 24 DHJETOR (ER) - Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët "Emin Duraku" në Kaçanik, "Idriz Seferi" në Bob, "Jusuf Gërvalla" në Biçec, "Kadri Zeka" në Dubravë, "Nazmi Osmani" në Elezaj dhe "7 Shtatori" në Begracë janë furnizuar me pajisje dhe material shpenzues për Kabinetet e Fizikës dhe

Biologjisë.

Komuna e Kaçanikut ka njoftuar se pajisjet dhe materiali shpenzues për këto shkolla kap shumën prej 62 487 euro ose 10 414 50 eurosh për secilën shkollë. Mjetet financiare janë siguruar nga buxheti i kësaj komune, të dedikuara për Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës.



Guvernatori Mehmeti: Viti 2018 ishte me zhvillime pozitive në sektorin financiar

**EPOKA
ERE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka thënë se në vitin 2018 norma reale e rritjes ekonomike është 4 për qind, përderisa në vitin 2019 rritja ekonomike pritet të arrijë në 4.2 për qind. Në konferencën përmbyllëse të fundvitit, guvernatori Mehmeti ka përmendur aktivitetin e sektorit bankar që gjatë këtij viti u karakterizua me rritje të kreditimit, përmirësim të kushteve për qasje të sektorit privat në kredi, si dhe përforsim të mëtejme të gjendjes së qëndrueshmërisë. "Kreditë e sektorit bankar arritën shumën prej 2.7 miliardë eurosh në tetor 2018, duke shënuar rritje vjetore prej 11.6 përqindësh. Burim kryesor i financimit të aktivitetit të sektorit bankar vazhdojnë të jenë depozitat, vlera e të cilave gjatë kësaj periudhe arriti në 3.2 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 6.9 përqindësh. Normat e interesit në kredi vazhduan trendin rënës, duke zbritur në 6.6 për qind nga 6.8 për qind sa ishin në periudhën e njëjtë të periudhës së kaluar, që tregon për lehtësim të vazhdueshëm të qasjes në financim bankar. Treguesit e shëndetit

financiar vazhduan të tregojnë nivel të lartë të qëndrueshmërisë së këtij sektori në të gjitha aspektet. Vlen të theksohet posaçërisht cilësia shumë e mirë e portofolit kreditor me një normë të kredive joperformuese prej vetëm 2.7 përqindësh në tetor të 2018-s, e cila shënoi rënie të mëtutjeshme në krahasim me vitin e kaluar kur ishte 3.6 për qind", ka deklaruar guvernatori Mehmeti.

Në kuadër të faktorëve me ndikimin më të rëndësishëm për financimin e rritjes ekonomike, sipas guvernatorit, ishin përshpejtimi i rritjes së kreditimit për sektorin privat, rritja e shpenzimeve publike, si dhe rritja e remitencave të cilat deri në muajin shtator arritën vlerën 587.9 milionë euro, e cila është për 6.1 për qind më e lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. "Me zhvillime të favorshme u karakterizuan edhe sektorët e tjerë përbërës të sistemit financiar. Vlera e aseteve të sektorit pensional në shtator të 2018-s arriti në 1.76 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.2 përqindësh. Gjithsej vlera e shkruar e primeve nga kompanitë e sigurimeve në shtator 2018 ishte 69.1 milionë euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 4.8 përqindësh. Në anën tjetër, vlera e dëmeve të



paguara arriti në 31.5 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.2 përqindësh. Gjithsej vlera e kredive nga institucionet mikrofinanciare deri në tetor 2018 arriti vlerën prej 177.7 milionë eurosh, duke shënuar rritje vjetore prej 29.1 përqindësh. Sidoqoftë, një rënie e normës së interesit nga niveli aktual mesatar prej 23.1 përqindësh do ta bënte këtë sektor edhe më konkurrues dhe me rol më të madh në mbështetjen e ekonomisë së vendit", është shprehur ai.

Gjatë kësaj konference

Mehmeti ka përmendur edhe rritjen e angazhimit të BQK-së në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare. Gjithashtu, ka përmendur harmonizimin e kornizës rregullatore me zhvillimet e fundit ndërkombëtare në këtë fushë, më konkretisht në Bashkimin Evropian, përpilimin e rregulloreve të ndryshme, ndër të cilat edhe ato që avancojnë aspekte të ndryshme të rregullativës bankare siç janë Rregullorja e SNRF 9 Instrumentet Financiare dhe Rregullorja për Kreditë

Joperformuese dhe Ristrukturimet. Ndërsa ka njoftuar edhe për angazhimin e BQK-së në rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke veçuar nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit me Bankën Qendrore Evropiane, e cila i hap rrugë rritjes së bashkëpunimit me këtë institucion dhe siguri i kodit ndërkombëtar LEI për Republikën e Kosovës, e cila i mundëson Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës një trajtim të barabartë me bankat e tjera qendrore për realizimin e transaksioneve financiare.

Rukiqi: Rritja ekonomike në 4.2 për qind nuk është e qëndrueshme

PRISHTINË, 24 DHJETOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi, në konferencën përmbyllëse për vitin 2018, ka thënë se viti 2019 do të jetë i fokusuar në luftimin e informalitetit në vend. "Do t'i avancojmë strukturat të cilat promovojnë ekonominë tonë, sidomos investimet dhe eksportet. Për herë të parë do të kemi konferencë ndërkombëtare për tregun e punës për të diskutuar rreth vendeve të punës në mënyrë që të shohim se nga duhet të orientojemi. Viti 2019 për OEK-un do të jetë vit i luftës kundër informalitetit. Informaliteti është sfida për të gjithë. Edhe kompanitë më të zhvilluara janë të interesuara që të ketë treg të barabartë", ka thënë Rukiqi. I pari i OEK-ut ka folur edhe për rritjen ekonomike, duke theksuar se reformat e ndërmarra në këtë sektor kanë ndikuar pozitivisht, por ai ka shtuar se

kjo rritje nuk është e qëndrueshme pasi është e varur nga remitancat dhe jo nga zhvillimi i sektorit privat. "Rritja ekonomike në 4.2 për qind nuk është e qëndrueshme pasi nuk mbështetet nga zhvillimi i sektorit privat. Ne duhet ta zvogëlojmë varësinë ndaj remitencave dhe rritja duhet të mbështetet në sektorin privat", është shprehur Rukiqi. Ai ka folur edhe për vendimin e Qeverisë për taksën 100 për qind. Sipas tij, ky vendim ka ndikuar në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve mbi produktet vendore. "Për taksën 100 për qind po konsiderohet se në 80 për qind të qytetarëve ka ndikuar rritje e vetëdijes për produktet tona. Si ngritje e vetëdijes kisha për të cekur që shumë kompani tona kanë riorientuar aktivitetet e tyre për mundësitë apo për alternativat nga vendet e tjera që nuk janë prodhime serbe. Pas taksës



Qeveria ka arsye të gjejë resurse në promovim të eksporteve. Pavarësisht se kemi një numër të madh të brendeve ndërkombëtare

që sadopak çojnë sinjale për investime, ne mbesim vendi me më së paku investime të huaja direkte. Ka vite që

kërkojmë që Kosova të ketë pushime tatimore dhe subvencionime të vendeve të punës", ka thënë Rukiqi.

Interesi nacional është mbi çdo interes tjetër

Historia ka qenë më shumë se një njerë për shqiptarët. Shpesh, duke mos treguar vëmendje historike, "njerë" ia kemi zgjatur jetën. Qysh? Duke i rënë: njëri hunit, tjetri patkoit!



Fehmi AJVAZI,
politolog

Ka kohë që vendi ynë, Kosova, ndryshe nga hapësirat e tjera etnike, përballet me proceset e zhvillimit si shoqëri post luftë, por edhe si shoqëri në konsolidim institucional dhe shtetëror. Natyrshëm, "konsolidimi" lidhet me shumë procese, disa prej të cilave edhe janë kaluar me mjaft sukses si, për shembull, shpallja e pavarësisë, njohja e Kosovës nga më shumë se 115 shtete, anëtarësimi në disa mekanizma vital ndërkombëtarë, themelimi de jure i forcave të armatosura etj. Tani s'kemi pse të humbim kohë lidhur me disa procese të kaluara, meqë ato janë në evoluim e sipër: forcimi i demokracisë, forcimi i shtetit ligjor, zhvillimi ekonomik etj. Mirëpo, ende kemi përpara procese të rëndësishme, siç është anëtarësimi i Kosovës në disa mekanizma vitalë ndërkombëtarë (OKB, NATO), dhe, pa dyshim, zgjidhja e problemeve të ndryshme me fqinjin tonë verior: Serbinë.

Zgjidhja e problemeve politike dhe historike me Serbinë, tani është aktuale. Në kontekst,

beteja është duke u zhvilluar mbi rivalitete të ashpra brenda të cilave rivalitete, ne kemi përballë një Serbi që jo vetëm nuk e ka ndryshuar qasjen ndaj nesh, por vazhdon me të gjitha forcat ta pengoj dhe ta denigroj Kosovën në çdo aspekt. Pra ky "horizont" armiqësorë në veri, na obligon dhe na detyron të jemi të mobilizuar kundrejt qëllimeve dhe objektivave tona. Me këtë rast, nuk ka shumë paqartësi, filozofime, teorizime etj. Megjithatë, disa "izma" nxjerrin krye goxha shumë dhe shndërrohen hap mbas hapi në një lloj orteku të frikshëm. Fijet e ortekut, të vjetra e të reja, një pjesë e të cilave janë të tjerra nga dora e njerëve të ndryshme, na shqiten nëpër këmbët tona. Kuptimi dhe ngjyra e "fijeve", vjen nga kthinat e errëta të historisë. Pra, historikisht, ka një lloj përsëritjeje të pengesave, të keqkuptimeve dhe të sfidave të cilat, pikërisht në kohën kur dalin në pah për tu zgjidhur çështje me karakter nacional, në të njëjtën kohë "izmat" shpërthejnë si divergjencja, si mos pajtime, si konflikte etj. E kundërta e tyre, pra e kundërta e "izmave" (pa shkuar larg në histori), duam të marrim si shembuj të kontekstit pozitiv dy veprime të fuqishme me karakter të interesit nacional: Konferencën e Rambujesë (1999), dhe Shpalljen e Pavarësisë (2008). Të dy këto ngjarje, janë shpërfaqur si dy ngjarje të interesit nacional, duke dalë mbi çdo interes tjetër! Në të dy këto

raste, skena politike dhe partiake, shoqëria, me një fjalë populli, ka treguar unitet të fuqishëm dhe ka lënë prapa krahëve çdo gjë tjetër.

Megjithatë, edhe një herë tjetër, Kosova gjendet në një pozicion të atillë ku ka përpara një çështje të hapur: marrëdhëniet me Serbinë. Ekuivalent me problemet e tjera, të brendshme dhe të jashtme, kjo çështje nuk është që mund të injorohet në pakufi, dhe nuk mund të shmanget! Në kontekst, duke qenë si "një çështje reale", përgjatë vitit 2018 (brenda vendit dhe rreth tij), janë shfaqur shumë debate publike, fërkime të brendshme politike dhe partiake, fërkime institucionale, incidente me Serbinë, fërkime dhe ngecje në planin ndërkombëtar etj. Kështu ka pasur humbje kohe, ngecje, prolongime të proceseve, migracion etj. Natyrisht, kanë ndodhur edhe ngjarje që s'harrohen, si për shembull formalizmi edhe de jure i ushtrisë së Kosovës, mirëpo çështja e zgjidhjes së problemeve me fqinjin verior, Serbinë, ka shkaktuar dhe po shkaktonte probleme të theksuara. Nuk them se Prishtina është fajtorë, as se dialogu mes dy vendeve nuk ka përfunduar me fajin e Prishtinës! Përkundrazi. S'ka dyshim që Serbia e ka përdorur dhe po e përdor "dialogun" si konopin: tërhiqe, dhe mos e këput! Dhe në këtë mënyrë, Serbia jo vetëm që ka arritur ta mbajë si një lloj pengu Kosovën, por edhe ka përfutur shumë në këtë drejtim, sidomos ekonomikisht.

Ditët e fundit, sidomos pas formimit të ushtrisë, janë shfaqur shenja që sinjalizojnë veprime të fundme të dialogut në mes të Prishtinës dhe Beogradit, e të cilat veprime,

duhet të mbyllen me njohjen reciproke të dy vendeve si shtete të barabarta. Pra, dialogu jo vetëm që duhet të vazhdojë, por duhet të finalizohet përfundimisht. Në kontekst, Prishtina nuk ka pse të frikësohet nga dialogu. Ndërsa fundi i tij, duhet të mbyllet me marrëveshje reale. Në anën tjetër, kundrejt "çështjes", partnerit të deridjeshëm në involvim, Bashkimin Evropian, sipas të gjitha gjasave mund t'i bashkohet edhe partneri ynë politiko-strategjik, Amerika. Letra, tashmë e njohur e presidentit të ShBA-së, Donald Trump, jep sinjale në këtë drejtim.

Siç mund të kuptojmë, viti i ardhshëm 2019, do të jetë vit historik për Kosovën. Mirëpo, pajtohem me faktin se historia, jo njëherë, ka qenë më shumë se një njerë për ne! Veçse, disa herë, duke mos treguar vëmendje historike, bashkëveprim, unitet, njerë ia kemi zgjatur jetën me duart tona. Qysh? Duke i rënë: njëri hunit, e tjetri patkoit! Pra, besoj thellë se qarqet e brendshme politiko-partiake dhe institucionale, e kanë mjaft të kuptueshme "fazën e re" të detyrave dhe të përgjegjësiave me karakter nacional përgjatë vitit 2019. Kështu, individët me përgjegjësi, partitë, institucionet, grupet relevante, mediat etj., pavarësisht nga pozitat e tyre dhe nga rolet që kanë, duhet të çlirohen urgjentisht prej çdo lloj dileme, prej çdo lloj marrëveshjeje, dhe prej çdo lloj irritimi, inati dhe veprimi intrigues në mënyrë që, të gjithë (pa dallim), t'i përgjigjen momentit dhe çështjes që lidhet me arritjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme me Beogradin. Është logjike që, secili duhet të japë kontributin e tij. Edhe ashtu, Beogradi do të bëjë çdo gjë që ta fajësojë Prishtinën.

Sigurisht, edhe atëherë kur 100% nuk do të ketë të drejtë! Në kontekst, të qëndruarit më anash e gjithë atyre që nuk duhet, kritizimi vend e pavend, pasiviteti dhe manarët e tjera, për mendimin tim nuk mund të justifikohen me asgjë. Pra, duhet klasifikuar qëndrimet, duhet studiuar veprimet, dhe mbi të gjitha duhet sistemuar interesat sepse, nuk ka një interes tjetër, e që mund të rangohet mbi interesin nacional.

Shtendosja dhe përfundimi i armiqësisë (de jure) me Beogradin, nuk ka dyshim që është interes nacional yni. Jam koshient të konstatoj qysh këtu se, as pas çdo marrëveshjeje "de facto dhe de jure", armiqësia e Beogradit nuk do të përfundojë, mirëpo, ne duhet të bëjmë detyrën tonë dhe nuk duhet të lejojmë që të mbesim peng, dhe as të mbesim fajtorë ndërkombëtarë! Prandaj, si edhe në të kaluarën (ky nuk është shkrimi im i parë i kësaj natyre), unë i mbështes veprimet e bashkuara-unike të cilat, favorizojnë dhe forcojnë interesin nacional. Kësaj radhe, edhe më shumë! Pse? Në këtë rast, kemi përballë një Serbi që jo vetëm nuk e ka ndryshuar qasjen ndaj nesh, por vazhdon me të gjitha forcat ta pengoj dhe ta denigroj Kosovën në çdo aspekt. E ne, nuk mundemi dhe as nuk guxojmë të matufosemi pas interesave individuale dhe grupore, pas interesave politike dhe partiake, pas deklaratave dhe debateve pa fund e krejt pa shije, sa për t'ua zgjatur jetën njerëve të historisë, e po ashtu, edhe për tu fundosur në pellgun e mos zhvillimit dhe armiqësi të brendshme e të jashtme.

Suma - sumorum, vetëm të bashkuar, ne mund t'i heqim nga këmbët tona fijet e ortekut: të vjetra e të reja...

Gjykata Kushtetuese refuzon ta shqyrtojë rastin e Aida Dërgutit

PRISHTINË, 24 DHJETOR (ER)- Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka refuzuar të vendosë masë të përkohshme si dhe ta shqyrtojë kërkesën e 11 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, të cilët kërkuan nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 06/V145 të Kuvendit të

Republikës së Kosovës përkitazi me propozimin e grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje! për shkarkimin e Aida Dërgutit nga pozita e nënkryetares së Kuvendit. Gjykata Kushtetuese përfundoi se kërkesa është pa objekt shqyrtimi dhe, si e tillë, kërkesa për masë të përkohshme është refuzuar.



Narkoza e vizave - mit apo realitet (4)



Shkruan: Agron HOTI

Takati jonë

Pavarësisht prej vështirësive të brendshme dhe të jashtme, Kosova brenda dhjetë vjetëve si shtet ka arritur të krijojë institucione solide, të krahasueshme me rajonin, sa çdo ditë e më shumë është duke hyrë në marrëdhënie biletarale e multilaterale me shtete dhe organizata të ndryshme si dhe duke u anëtarësuar në mekanizma ndërkombëtarë të profileve të ndryshme me karakter rajonal dhe global. Vlen të theksohet që Kosova prej vitit 2009 e deri në këtë vit ka hyrë në mbi 330 marrëveshje ndërkombëtare të të gjitha llojeve. Dhe kjo, përpos që e obligon Kosovën t'u përmbahet këtyre marrëveshjeve, tregon edhe besimin që shtete dhe mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë kanë në institucionet e Kosovës. Vetëm për vitin 2019 e 2020 Kosova do të marrë mbi 200 milionë euro nga BE-ja, diçka që tregon besim dhe përkushtim të përbashkët drejt rendditës evropiane. Përpjekjet për anëtarësim në Interpol, UNESCO, shkojnë në këtë drejtim edhe pse kjo nuk varet tërësisht nga Kosova, kur dihet se çfarë obstrukcionesh bën Serbia e Rusia për ta penguar hapur Kosovën në këtë drejtim. Vetë fakti se Kosova ka arritur të nënshkruajë me BE-në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (MSA) dhe që çdo vit nënshkruan marrëveshje financiare me BE-në, me institucione financiare ndërkombëtare dhe me partnerë strategjikë bilateralë dhe multilateralë, tregon shumë për besimin që këto shtete dhe mekanizma zyrtarisht shprehin ndaj institucioneve të Kosovës. Përmirësimi dhe investimet e mëdha në infrastrukturë tejkalojnë çdo pritje të një shteti dhjetëvjeçar, aspekt ky që shteteve u ka marrë mbi 100 vjet. Pra, ka aq shumë arritje në infrastrukturë për këta 10 vjet shtet sa askush nuk do ta besonte. Sektori financiar në Kosovë është më stabil në rajon dhe për këtë s' do koment. Sigurisht se ka shumë punë për t'u bërë në vitet që vijnë, por sfidat e vështirësitë shtetërore janë përditshmëri edhe për

shtetet më të fuqishme të botës. Pra, s' do mend se procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës ka kaluar në një dramë maratonike, për të cilën flet i madh e i vogël. Ndërkohë që subjektet politike në Kosovë, për efekte të pastra elektorale, vjellin vrer duke kritikuar institucionet e Kosovës për mosliberalizim të vizave, edhe pse janë plotësisht të vetëdijshme se si ecet në këtë proces dhe kush e ka timonin. E qytetari i Kosovës së sotme është shumë më kërkues se ç' ishte dje. Falë qarkullimit të shpejtë të informacionit si rezultat i teknologjisë informative. Duke pasur qasje në zhvillimet globale, duke e parë botën së paku përmes realitetit virtual, pritjet e qytetarëve të Kosovës tejkalojnë çdo mundësi të qeverive të sotme dhe të nesërme. Sigurisht se ngathtësia e shtetit të Kosovës në situata të caktuara nuk është për t'u nënvlerësuar. Derisa dje ishim të izoluar, sot shohim botën dhe pritjet do të jenë gjithnjë e më të mëdha. Prandaj, pritjet e qytetarëve janë sfidë për çdo qeveri në botë sado i fortë të jetë ai shtet. Rasti më tipik janë zgjedhjet në Bavari të Gjermanisë. Bavaria është pa dyshim vendi më i zhvilluar në Evropë, me papunësi pothuaj zero, me standardin më të lartë jetësor në Evropë e, ndoshta, edhe në botë, ndërkohë që, pavarësisht prej qeverisjes së vazhdueshme të CSU-së, kjo parti bashkë me CDU dhe SPD pësuan fiasco para partive populliste. Nuk duhet lënë anash rezultatit mbresëlënës që kanë arritur edhe të Gjellbrit. Ky grupim politik nuk definohet në taborin e partive populliste, por si mbrojtës i vlerave liberale, prandaj kjo revoltë ndaj establishmentit tradicional në rrethana të caktuara ka prod-

huar edhe afirmim të vlerave liberale.

Pra, nëse lidhshipi bavarez me një ekonomi të tejzhvilluar nuk ka arritur t'i bindë qytetarët që të votojnë prapë për ta, ose shumica e tyre, atëherë mund ta paramendojmë se çfarë do të ngjajë në vende me ekonomi të pazhvilluara siç janë Kosova dhe Ballkani, qeveritë e të cilave, ende pa filluar mandatin, do të përballen me kërkesa për zgjedhje të parakohshme, diçka të cilën veç jemi duke e përjetuar në Kosovë dhe rajon pothuajse rregullisht.

Rasti tjetër është rënia e rejtingut të kancelares gjermane Angela Merkel si rezultat i krizës së refugjatëve sirianë, rejtingu i së cilës u dëmtua shumë, edhe pse ekonomia e saj është më e forta në Evropë dhe ndër më të zhvilluarat në botë. Kjo tregon se sa e vështirë është duke u bërë vendim-marrja nëpër shtete të ndryshme edhe kur ato duhet të vendosin në të mirë të ekonomisë së tyre, në këtë rast nevoja për fuqi punëtore në Gjermani është evidente dhe natyrisht se kjo zbrazëti nuk do t'i mbushet me punëtorë nga vendet e BE-së, por sigurisht nga vende joevropiane, e sfida fillon pikërisht këtu. Edhe shembulli i Japonisë tregon për vështirësitë e drejtimit të vendit. Ky vend është duke u përballur me rënie të lirë demografike, plakje të popullsisë, ridimensionim social, mbi 50 % e fëmijëve të lindur në Japoni pritet të jetojnë mbi 100 vjet, jogatishmëria e popullsisë japoneze për të pranuar fuqi punëtore të huaj etj. Për këtë arsye, qeveria japoneze, për t'i përballuar këto vështirësi, është duke shikuar mundësitë e rritjes së robotikës nëpër vende të punës, pranimin e fuqisë

punëtore nga jashtë dhe shtyrjen e kohës së pensionimit mbi 70 vjeç. Të gjithë këta hapa janë duke u bërë me qëllim të mbajtjes gjallë të ekonomisë japoneze, edhe pse asnjë prej tyre nuk do të jetë e lehtë të zbatohet në praktikë.

Pra, shembujt e mësipërm tregojnë se pritjet e mëdha në njërën anë dhe mundësitë e kufizuara në anën tjetër do të bëjnë që rejtingu i çdo politikani të njohë vetëm rënie sapo ta marrë postin. Fakti që kryetarit të Francës, të ShBA-së, Britanisë së Madhe etj. fillon t'u bjerë rejtingu qysh prej ditës së parë sapo marrin postin, tregon se sa e vështirë është bërë mbajtja gjallë e lidhshipit para qytetarëve. Dhe kur lidhshipi po u bie shumë shpejt edhe udhëheqësve të vendeve të forta, atëherë atyre të vendeve me zhvillim të ulët ekonomik siç është Kosova do t'u bjerë me rënie të lirë.

Kritikët

Kosova prej pasluftës e deri më sot asnjëherë nuk ka pasur opozitë të mirëfilltë. Vazhdimisht për hir të stabilitetit të vendit është dashur që forcat politike pa marrë parasysh orientimet partiake të votonin pako ligjesh, planesh e marrëveshjes ndërkombëtare pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë. Sigurisht që kjo e ka penguar zhvillimin e demokracisë, pasi demokracia si e tillë duhet të lind, sepse nëse imponohet, nuk e ka efektin natyral që ishte dashur ta ketë. Çështja e statusit të Kosovës ka humbur vazhdimisht relevancën e partive opozitare dhe kjo ka penguar vazhdimisht zhvillimin e demokracisë në vend. Qeverisje të përbashkëta, grupe uniteti, kalimi i pakove ligjore, planeve e marrëveshjeve për

hir të statusit dhe stabilitetit, dialogimi i pafund me Serbinë, vazhdimisht e kanë zbehur rolin e opozitës si një nga degat kryesore të zhvillimit të demokracisë. Dhe duke qenë vazhdimisht kështu, forcat politike, si opozitare ashtu dhe të pozitës, janë bashkëbartëse të të gjitha proceseve që kanë ndodhur deri më tani, kush më pak e kush më shumë dhe se çdo kritikë ndaj dikujt pikë së pari duhet nisur nga vetvetja. Një pjesë e opozitës kritikon procesin, pjesë e të cilit ka qenë në të gjitha fazat e tij, ndërsa një pjesë tjetër e opozitës, e dalë nga fryma e një popullizmi shterp në rritje, jo vetëm në Kosovë, por gjithandej Evropës dhe e zhytur thellë në ideologji majtiste, mundohet të përfitojë nga ky momentum duke dalë në, kinse, 'mbrojtje' të Republikës. Ndërkohë që, në anën tjetër, është vetë ky subjekt majtist që nuk ka votuar në favor të MSA-së në Kuvendin e Kosovës. E Kosova vetëm një herë e ka votuar MSA-në, pra nuk do ta votojë prapë, siç mund ta ketë menduar dikush, kurse tash e tutje në rend-dite do të jenë hapa të tjerë të integritit evropian. Pra, për çfarë integrimi evropian na flet ky subjekt majtist, kur haptazi pat dalë kundër këtij procesi, pas të cilit sot thirret se e do. Ky subjekt majtist vazhdimisht ka qenë kundër çdo iniciative perëndimore në Kosovë, ka sfiduar dhe sfidon çdo propozim progresist dhe mbështetje perëndimore si, p. sh., ka kundërshtuar dhe kundërshton edhe sot pavarësinë e Kosovës etj. Një subjekt politik që nuk e njeh shtetin dhe simbolet e tij, me çfarë të drejte flet për regres në procesin e integritit evropian, përfshirë procesin e liberalizimit të vizave, ndërsa vazhdimisht punon kundër saj me kursin e saj rrënues. Për çfarë opozite mund të flasim, kur nuk është në gjendje t'i përcjellë dinamikat zhvillimore në vend, një opozitë që propozon diçka dhe vetë nuk e voton, një opozitë që në mungesë totale të alternativave tërë kohën flet vetëm për zgjedhje pa asnjë zgjidhje, një opozitë që nuk ka guxim të përballet me asnjë problem. Pra, tërë ditën fajëson për mosliberalizim të vizave, duke mos qenë në gjendje të reflektojë ndaj asnjë zhvillimi të mundshëm. Sigurisht se opozita është pjesë integrale e zhvillimit demokratik, por duke u marrë me individë e jo me procese siç duket e ka çorientuar dhe shkapërderdhur në tërësi.

(Vijon)



Kush do të jetë shefi i ardhshëm i Pentagonit?



UASHINGTON, 24 DHJETOR - Largimi më herët sesa pritej i sekretarit amerikan të Mbrojtjes, Jim Mattis, e ka zhvendosur vëmendjen tek emërimi nga presidenti Donald Trump i një shefi të ri të Pentagonit.

Zëvendëssekretari i Mbrojtjes, Patrick Shanahan, do të jetë sekretari në detyrë i mbrojtjes duke filluar nga 1 janari, sipas një njoftimi të presidentit Trump me një koment në "Twitter" të dielën. Shanahan ka

punuar për më shumë se tri dekada në kompaninë Boeing dhe ishte zëvendësprezident i kompanisë kur mori postin e zëvendëshefit të Pentagonit në korrik 2017.

Zyrtarët amerikanë thanë se nuk e dinë nëse Shanahan do të jetë kandidati i presidentit për postin e shefit të ri të Pentagonit për ta zëvendësuar Mattisin.

Në Shtetet e Bashkuara është mjaft e pazakontë që Pentagoni të ketë një sekretar në detyrë.

Historikisht, kur një sekretar i Mbrojtjes jep dorëheqje, ai qëndron në post deri në konfirmimin e një pasardhësi.

Dorëheqja e Mattisit shënoi fundin e tensioneve në marrëdhëniet midis tij dhe presidentit Trump që ishin thelluar muajt e fundit. Javën e kaluar thyerja mes tyre u bë e plotë pas vendimit të Trumpit për t'i tërhequr trupat nga Siria. Ajo u bë publike me letrën e dorëheqjes që Mattis i paraqiti presidentit.

Nënshkruhet urdhri për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria

Pas njoftimit të presidentit Donald Trump për tërheqje të plotë, një zëdhënës i Ushtrisë amerikane ka thënë se është nënshkruar urdhri për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria

UASHINGTON, 24 DHJETOR - Pentagoni ka thënë të jetë nënshkruar urdhri për tërheqjen e trupave amerikane nga Siria, pas njoftimit të presidentit amerikan Donald Trump më 19 dhjetor për tërheqje të plotë, kanë raportuar mediet amerikane. "Urdhri ekzekutiv për Sirinë është nënshkruar", është cituar të ketë thënë një zëdhënës i Ushtrisë amerikane më 23 dhjetor, ka raportuar agjencia e lajmeve, AP.

CNN-i ka thënë se një zyrtar i Mbrojtjes ka konfirmuar se urdhri është nënshkruar dhe është cituar të ketë thënë se sekretari amerikan i Mbrojtjes, në shkuarje tashmë, James Mattis, ka vënë nënshkrimin në këtë urdhër.

Presidenti Trump ka deklaruar më 19 dhjetor fitore kundër grupit militant, Shteti Islamik (IS) në Siri dhe ka bërë njoftimin e papritur për tërheqje të plotë të trupave prej vendit të shkatërruar nga lufta.

Trumpi ka pranuar kritika nga ligjvënësit demokratë si dhe ata republikanë, duke përfshirë edhe ish-liderë qeveritarë dhe aleatë ndërkombëtarë, për atë që është cilësuar si tërheqje e parakohshme e forcave amerikane nga Siria.

Në këtë vend forcat amerikane kanë mbështetur sirianët arabë dhe ata kurdë në luftën kundër IS-it nga viti 2015.

Shumë kundërshtarë kanë thënë se tërheqja e shpejtë e trupave të ShBA-së do të përbënte tradhti për aleatët kurdë, të cilët mund të rrezikohen nga forcat turke, pasi Ankaraja akuzon kurdët në Siri se kanë lidhje me Lëvizjen kurde që realizon kryengritje në Turqi.

Madje për disa kritikë, tërheqja amerikane mund të konsiderohet edhe fitore për Iranin dhe Rusinë që janë aktive në këtë shtet.

Presidenti francez Emmanuel Macron ka thënë se ai ndien "keqardhje të thellë" për



vendimin e Trumpit, duke shtuar se "aleatët duhet të jenë të besueshëm".

Ndërkohë disa nga aleatët më të ngushtë të Trumpit kanë tentuar edhe publikisht ta bindin presidentin amerikan për ta tërhequr vendimin e tij për Sirinë. Pasi Trumpi ka njoftuar për planet e tij, Jim Mattis ka njoftuar për dorëheqjen e tij nga pozita e sekretarit amerikan të Shtetit,

duke protestuar për politikën e jashtme të presidentit.

Pas këtij vendimi ka dhënë dorëheqje edhe i dërguari amerikan në koalicionin global për luftimin e IS-it, Brett McGurk.

Siria është përballur me luftë shtatëvjeçare. Rusia dhe Irani kanë përkrahur presidentin sirian Bashar al-Assad, ndërkohë që Shtetet e Bashkuara dhe

Turqia kanë mbështetur palë të ndryshme kundërqeveritare.

Kësaj lufte i janë bashkuar edhe ekstremistët e grupit, Shteti Islamik. Megjithatë, edhe pas zotërimit të një pjese të madhe të territorit në Siri dhe Irak, dhe shpalljes së "kalifatit", militantët e IS-it kanë humbur pas pak kohësh të gjitha bastionet dhe janë dëbuar nga shumica e zonave të dyja shtetet.



Zgjedhjet e parakohshme në Izrael, në prill të vitit të ardhshëm

TEL-AVIV, 24 DHJETOR - Izraeli do të mbajë në muajin prill zgjedhje të përgjithshme të parakohshme, njoftoi zëdhënësi i kryeministrit, Benjamin Netanyahu, pasi anëtarët e koalicionit qeverisës u takuan

për të diskutuar rreth dallimeve për legjislacionin. "Koalicioni qeverisës vendosi njëzëri ta shpërndajë parlamentin dhe të shkohet në zgjedhje të reja në fillim të prillit", tha zëdhënësi përmes rrjetit social "Twitter",

duke cituar një deklaratë të lëshuar nga partnerët e koalicionit qeverisës. Netanjahu, tani në mandatin e tij të katërt si kryeministër, ka qeverisur me një shumicë prej 61 vendesh në parlamentin 120-anëtarësh.

Barcelona në alarm nga rreziku i sulmeve terroriste

BARCELONË, 24 DHJETOR - Qyteti i Barcelonës u gjend në alarm të hënën, pasi Departamenti i Shtetit i ShBA-së paralajmëroi rrezikun e sulmeve terroriste gjatë festës së Krishtlindjes. Kujdesi u rrit rreth zonave ku lëvizin automjetet trans-

portuese përfshirë autobusët në pjesën e Las Ramblas të Barcelonës, shkruan AFP. "Terroristët mund të sulmojnë me pak ose asnjë paralajmërim, duke shënjestruar lokacionet e turistëve, qendrat e transportit dhe zonat e

tjera publike", paralajmëroi Byroja e çështjeve konsullore të Departamentit të Shtetit të hënën përmes "Twitter"-it. I pyetur gjatë një interviste në "Rac1 radio", ministri i Brendshëm rajonal, Miquel Buch, tha se policia "po

angazhohet për trajtimin e këtij kërcënimi". Gazeta "El Peridico de Catalunya" njoftoi se policia rajonale ka lëshuar një qarkore të brendshme ku thuhet se një person mund të tentojë ta godasë turmën me autobusë.



Muzeu Kombëtar i Kosovës ndryshon statutin e 1978-s

Në një ceremoni solemne, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar statutin e Muzeut të Kosovës. Me këtë statut, ndër të tjera, përcaktohen dhe rregullohen mandati, veprimtaria, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, statusi juridik, organizimi i brendshëm, burimet e financimit, përzgjedhja, organizimi i punonjësve profesionalë, administrativë dhe teknikë si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm

PRISHTINË, 24 DHJETOR (ER) - Nga dita e hënë Muzeu i Kosovës bëhet me statut, akt ky i cili ia përcakton mandatin dhe rregullon punën e këtij institucioni të trashëgimisë kulturore të Kosovës. Në një ceremoni solemne, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar statutin e Muzeut të Kosovës. Me këtë statut, ndër të tjera, përcaktohen dhe rregullohen mandati, veprimtaria, organet drejtuese dhe kompetencat e tyre, statusi juridik, organizimi i brendshëm, burimet e financimit, përzgjedhja, organizimi i punonjësve profesionalë, administrativë dhe teknikë si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Me nënshkrimin e këtij akti ky institucion emërtohet Muzeu Kombëtar i Kosovës me shkurtesën MKK. Statuti përcakton organet drejtuese të MKK-së, Këshillin Drejtues dhe drejtorin e MKK-së. Këshilli Drejtues, i cili përbëhet nga pesë anëtarë dhe me një

mandat katërvjeçar, ndër të tjera, harton dhe aprovon politikën afatgjatë të institucionit, aprovon programin vjetor të punës së MKK-së, zgjedh dhe shkarkon drejtorin e Muzeut. Ndërkaq statuti përcakton edhe detyrat e drejtorit të MKK-së, i cili zgjidhet përmes një konkursi publik që shpall MKRS-ja, me një mandat katërvjeçar dhe me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Ai, mes shumë detyrave dhe përgjegjësi, koordinon dhe organizon punën e MKK-së, e propozon te Këshilli Drejtues planin vjetor të punës, merr pjesë në mbledhjet e Këshillit pa të drejtë vote, përfaqëson MKK-në brenda dhe jashtë shtetit.

Me rastin e nënshkrimit të statutit të MKK-së, ministri Gashi ka thënë se nënshkrimi i këtij dokumenti është i rëndësishëm së veçantë për të kaluarën e vendit tonë. "Së bashku po kurorëzojmë një sukses të përbashkët, të arritur falë përkushtimit dhe angazhimit



disamujorë të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Muzeut si dhe stafit profesional të këtij institucioni, pra nënshkrimin e Statutit të Muzeut të Kosovës", ka thënë ai.

Ministri Gashi ka folur rreth rëndësisë së statutit të Muzeut dhe për objektivat themelore të tij, duke thënë se pas 40 vjetëve nga koha kur është miratuar statuti i fundit më 1978 dhe 20 vjet pas luftës në Kosovë, Ministria po i ofron dokumentin themelor muzeut, statutin, si akt ligjor kryesor i funksionimit të institucionit me vlerë të jashtëzakonshme për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe his-

torike. "Ky statut e mundëson për herë të parë evidentimin, regjistrimin dhe digitalizimin e fondit muzeor të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, mundëson ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimit muzeor një veprimtari me të konsoliduar si në aspektin profesional, po ashtu edhe në atë shkencor. Mbi të gjitha, ky statut e ngre si institucion të administratës shtetërore, pra si muze kombëtar", ka sqaruar ministri Gashi. Ministri Gashi ka premtuar se vitin e ardhshëm do ta avancojë legjislacionin për muzetë në Republikën e Kosovës. "Vitin e ardhshëm unë si ministër do ta

vendos në agjendë legjislative ligjin për muzetë e Kosovës, e që ky statut e ka bërë që të jetë si dokument udhërrëfyes se sa i nevojshëm është një ligj i tillë për muzetë e Republikës së Kosovës, vend me vlera të veçanta të trashëgimisë historike dhe kulturore", është shprehur ministri.

Në fund, ministri shprehu falënderim dhe mirënjohjen për grupin punues të këtij dokumenti të rëndësishëm së veçantë dhe rikonfirmoi mbështetjen e plotë dhe të pazezervë për të gjitha institucionet që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kuadër të Ministrisë së Kulturës.

QKK-ja sjell ekspertët e njohur të filmit në Kosovë

PRISHTINË, 24 DHJETOR (ER) - Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK) në partneritet me EAVE po organizon një punëtori katërditore (10-13 janar) për zhvillimin e projekteve filmike në Kosovë për producentët dhe skenaristët e nëntë projekteve të filmave të metrazheve të gjata me potencial ndërkombëtar të bashkëprodhimit. Qëllimi i kësaj punëtorie është zhvillimi i skenarëve dhe përmirësimi i aftësive të bashkëprodhimit të pjesëmarrësve, duke siguruar mjetet e nevojshme për të pasur sukses në tregun ndërkombëtar.

Punëtorja udhëhiqet nga ekspertët Jacques Achoti (ekspert i skenarit) nga Franca, ekspertja e produksionit Rashanak Behesht Nedjad nga

Gjermania dhe agjenti i shitjes Gabor Greiner nga Gjermania, të cilët do ta kombinojnë përvojën e EAVE-s për trajnimin dhe krijimin e rrjetit ndërkombëtar me një qasje të krijuar për producentët kosovarë dhe nevojat specifike të secilit projekt.

Punëtorja do të përbëhet nga ligjëratat nga ekspertët, seancat e punës në grupe dhe takime individuale për pjesëmarrësit-producuentë dhe ekipet e tyre krijuese, projektet pjesëmarrëse nga Kosova janë 'Lëkura e Krokodilit' nga Ilirjan Himaj, 'Dëbora' nga Arlinda Morina, 'Heshtja e Sirenave' nga Gazmend Nela, 'Hunting Bears' nga Edon Rizvanolli, 'The Tiny Walkers' nga Jeton Kulinxha, 'Njeriu me Valixhen Vjollce' nga Edin Alija, 'Tifozi i Jugosllavisë'



nga Arian Krasniqi, 'Ikja' nga Artur Tahiraj dhe 'Hotel Slavia' nga Besart Sllamniku.

Ligjëratat do të trajtojnë tema si: realizimi i skenarit, roli i producentit, shitjet, shpërndarja dhe tregu ndërkombëtar. Gjatë

sesioneve intensive të punës dhe takimeve individuale të ekspertëve dhe pjesëmarrësve të EAVE-s do të punohet së bashku për shkrimin dhe zhvillimin e skenarit, analiza strukturore/dramaturgjia, marrëdhënia

producent-skenarist/producent-regjisor, buxhetim dhe menaxhim financiar, ndërgjegjësimin e tregut dhe audiencës, shitjet dhe shpërndarjet, duke përfshirë parimet themelore të këtyre praktikave.

E jashtëzakonshme**Shteti që ka më shumë biçikleta sesa banorë**

Me 17 milionë banorë dhe 23 milionë biçikleta, Holanda tashmë ka më shumë biçikleta sesa njerëz. Dhe tani dëshiron të sjellë më shumë çiklistë në rrugë. Kjo do bëhet duke paguar njerëzit që përdorin biçikletë. Qeveria holandeze njoftoi se do të investojë 390 milionë dollarë (345 milionë euro) në infrastrukturën e çiklizmit që të



jenë 200 000 njerëz më shumë që udhëtojnë me biçikletë brenda tre vjetësh. Ndërsa është menduar të krijohet 25 000 mijë hapësira parkimi për biçikletat.

FOTO E DITES

Disa persona në Itali shihen të veshur me kostume Santa Claus duke lundruar në Venedik. /AP/

E rrallë**Gjenden mbetjet e kalit me parzmoren e tij në Pompei**

Mbetjet e një kali me parzmoren e tij janë zbuluar në një vilë jashtë mureve të Pompeit. Arkeologët e konsiderojnë si gjetje të rëndësishme të rrallë. Kali ishte i shaluar dhe mendohet se ishte bërë gati për të ndihmuar në shpëtimin e Pompeianëve që po mundoheshin të largoheshin



pas shpërthimit të malit Vezuvid, i cili i varrosi në hi. Ai u gjet së bashku me mbetjen e kuajve të tjerë në Vilën e Mistereve.

BARSOLETA E DITËS


- Shpresoj të vdes në gjumë si gjyshi im.
- Pse?
- Po më mirë të vdesësh në gjumë sesa duke bërë titur siç vdiqën pasagjerët e tij!

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC****“ALPHA” 3D,**

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross




Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

**DASHI**

Do të vini në zbatim gjithçka që keni mësuar gjatë këtyre ditëve. Sot do të nevojiten patjetër për të zgjidhur një situatë ngërçi.

**DEMI**

Nëse nuk dëshironi të keni kundërshtime nga të gjithë sot, mundohuni të shpjegoheni sa më qartë për gjërat dhe detyrat që ju kërkojnë.

**BINJAKËT**

Ka disa rrugë ku ju mund të shkëlqeni në karrierën tuaj personale, por ka rrugë të tjera të cilat mund të bëjnë persona afër jush të triumfojnë.

**GAFORRJA**

Disa argumente të caktuara sot mund të sjellin debate të ndezura në familje. Është mirë që çdo pjesëtar të dëgjojë tjetrin përpara se të flasë.

**LUANI**

Keni përballuar shumë sfida kohët e fundit dhe kjo ju ka dhënë mjaft vetëbesim. Mundohuni që në çdo fushë të jeni në të njëjtën frymë.

**VIRGJËRISHA**

Një situatë emergjente dhe që e kishit neglizhuar sot do t'ju shtrëngojë të rrini shumë më gjatë në punë. Nuk jeni të sigurt nëse do e zgjidhni.

**PESHORJA**

Dita do të nisë qetë, por disa të papritura do të ndryshojnë të gjithë rrjedhën e saj duke ju detyruar të anuloni disa plane tuajat.

**AKREPI**

Keni marrë përsipër disa aktivitete të pazakonta për ditën e sotme dhe do të shikoni që mund të jetë pak problem për t'i finalizuar.

**SHIGJETARI**

Nuk po merrni vendimin më të lehtë nga ana sentimentale, por do t'i bëni shumë mirë një personi të afërt me ju.

**BRICJAPI**

Nëse sot nuk ju pëlqen të debatoni lidhur me një problem të caktuar keni gjithë të drejtën të tërhiqeni dhe të tregoheni indiferentë.

**UJORI**

Rreth jush janë krijuar pritshmëri të caktuara sepse keni treguar që mund t'i realizoni dhe të bashkëpunoni në kohë rekord për gjëra të ndryshme.

**PESHQIT**

Ditët e fundit jeni në pritje të një lajmi të rëndësishëm që do të arrijë vetëm sot. Edhe pse do të zhgënjeheni pak do të rikuperoni rrugës.

David Beckham uron për Krishtlindje



David Beckham është futur në frymën e Krishtlindjeve. Ish-futbollisti 43-vjeçar ka postuar një fotografi të hënën në mëngjes

pak përpara festës. "Mirëmëngjesi dhe gëzuar Krishtlindjet!" Së fundmi Davidi është parë në rrugët e Londrës duke shëtitur me veturën "Aston Martin".

Rihanna kapet me të dashurin në një darkë romantike



Rihanna po kalon kohë të mirë me Hassan Jameelin. Këngëtarja 30-vjeçare është parë në një darkë romantike me të dashurin e saj, të shtunën në Malibu, Kaliforni. Çifti mbajti një profil të ulët dhe ishte i rrethuar nga sigurimi.

Rihanna dhe Hassan janë në lidhje që një vit, por lidhjen e kanë mbajtur shumë private. Ata fillimisht u panë gjatë verës së vitit të kaluar. Në anën tjetër, Rihanna së fundmi konfirmoi se do të kemi muzikë të re nga ajo në vitin 2019.



Selena Gomezi po duket e lumtur pas trajtimit psikiatrik

Selena Gomezi po duket shumë e lumtur. Këngëtarja është parë me miqtë e saj të dielën pasi kanë ngrënë drekë në Los

Angeles. Selena dukej e buzëqeshur dhe ky është një lajm i mirë. Ajo pak javë më parë ka dalë nga trajtimi në një spital psikiatrik.

Post Malone publikon këngën e re



Siç është premtuar, Post Malone është kthyer me një këngë të re të quajtur "Wow" dhe ju tashmë mund ta dëgjoni. Kënga u lëshua të dielën. Artisti fillimisht ka

paralajmëruar për publikimin e këngës përmes "Twitter"-it duke shkruar: "Këngë para përfundimit të vitit". Kënga është në bashkëpunim me DJ Khaled.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

**QENDRA SPORTIVE**

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BRIGHTON - ARSENAL

2

LEICESTER - MAN CITY

2

TOTTENHAM - BOURNEMOUTH

1

Milicaj: Dukagjini, kampionatin tjetër në Superligë

Mark Milicaj për "Epokën e re" ka thënë se skuadra e Dukagjinit në edicionin 2019/2020 do të bëjë gara në Superligë. "Nëse vazhdojmë me këtë ritëm, nuk besoj se do ta kemi problem inkuadrimit në Superligë, ani pse konkurrenca është jashtëzakonisht e fortë", ka thënë Milicaj

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Konkurrenca në Ligën e Parë në futboll për pozitën e parë që siguron rikthimin në Superligën e Kosovës në futboll është shumë e madhe, pas aty renditen skuadra të dëshmuara dhe me potencial të jashtëzakonshëm sikurse janë Besa, Vushtrria, Vëllaznimi dhe Trepça nga Mitrovica. Megjithatë, futbollisti me përvojë të madhe Mark Milicaj, i cili në afatin kalimtar të verës iu bashkua Dukagjinit, është optimist se skuadra nga Klina mund të jetë edicionin tjetër në elitë. Milicaj për "Epokën e re", po ashtu e vlerësoi sezonin vjeshtor si pozitiv për skuadrën nga Rrafshi i Dukagjinit. "Besoj se, po të kishim më shumë fat, do të kishim edhe më shumë pikë dhe do të ishim edhe më lart në renditjen tabelore, por në përgjithësi nuk jemi keq. Nëse vazhdojmë me këtë ritëm nuk besoj se do ta kemi problem inkuadrimit në Superligë, ani pse konkurrenca është jashtëzakonisht e fortë", ka thënë Milicaj.

Tri skuadrat kryesore që do të konkurrojnë ndaj Dukagjinit të Klinës, Milicaj i ka vlerësuar Besën e Pejës, Vushtrrinë dhe Vëllazninin e Gjakovës. Futbollisti me



tipare sulmuese që ka bërë karrierë edhe në Besën e Pejës, Istog dhe Feronikel, ka thënë se skuadrës nga Klina i duhen edhe përforsime për të qenë më serioze drejt synimeve që ka në këtë edicion garash. "Kemi futbollistë të shkëlqyer në skuadër, por për të qenë konkurrent i fortë me skuadrat e tjera, mendoj se Dukagjinit i duhen edhe tri përforsime. Pranvera do të jetë interesante dhe skuadrat do të kërkojnë me ngulmë arritjen e objekti-

vave që kanë", ka deklaruar ai.

Skuadra e Dukagjinit sezonin vjeshtor e mbylli e eliminuar nga Kupa e Kosovës dhe me fitore në kampionat ndaj Fushë-Kosovës me rezultat 0-1. Në renditjen tabelore kjo skuadër që e kërkon inkuadrimit në Superligë që disa vjet radhazi, është e treta me 33 pikë, dy pikë më pak se Besa që është e dyta dhe pesë më pak se Vushtrria që renditet në pozitën e parë.

SHKURT

Lorik Cana merr çmimin "O sa mirë me qenë shqiptar"

Në një aktivitet të zhvilluar nga grupi "Tifozat Kuq e Zi", ish-kapiteni Lorik Cana është vlerësuar me çmimin "O sa mirë me qenë shqiptar". Ky është një prej grupeve më të mëdha shqiptare të organizuara në mbështetje të kombëtares shqiptare të futbollit.

Avdijaj pezullohet nga Willemi

Pas një udhëtimi në tregun e Krishtlindjeve në Meppen, ylli i Kosovës, Donis Avdijaj, është pezulluar nga skuadra e tij Willem II. Por, shkëlqimin e tij në fushën e lojës sulmuesi i Kosovës e ka nën hijen e një problemi të shkaktuar së fundmi me tre bashkëlojtarë. Skuadra nga kampionati elitë holandez është përgatitur për t'u përballur në Emmen për ndeshjen e javës së 17, por gjërat s'kanë shkuar sipas planit. Pak para ndeshjes, në hotel, Avdijaj së bashku me tre bashkëlojtarë thyen rregullat duke mos pushuar dhe duke dalë në qytet për shëtitje. "SPORT1.de" raporton se Avdijaj me tre bashkëlojtarët janë pezulluar nga trajneri i skuadrës, Adrie Koster.

Panucci mund të largohet nga Shqipëria, shkak oferta e Romës

Pozitat e Eusebio di Franceskos në bankinën e Romës janë tronditur ndjeshëm në këtë sezon. Klubi verdhekuq tashmë ka nisur kërkimet për zëvendësuesin e tij dhe një prej emrave që kanë filluar të qarkullojnë kohët e fundit është ai i trajnerit të përfaqësueses shqiptare, Cristian Panucci, një emër ky i njohur për tifozët e skuadrës romane, duke qenë se ai ka kaluar një pjesë të mirë të karrierë si futbollist me fanellën verdhekuqe. Sipas së përditshmes italiane 'Il Messaggero', trajneri i kombëtares shqiptare, që është kurioz t'i mësojë nëse drejtuesit e Romës, e konsiderojnë vërtet si një kandidat të mundshëm për ta drejtuar këtë skuadër që ka zbritur në vendin e 10 të klasifikimit në këtë sezon të Serisë A. Gjithnjë sipas 'Il messaggero', Christian Panucci nuk i ka ndërprerë raportet me Franco Baldinin, ashtu sikurse edhe ato me De Rossin. Problemi në këtë pikë për Panuccin është kontrata që ai ka me Federatën Shqiptare të Futbollit, e cila skadon në nëntor të vitit 2019, kur mbyllet edhe faza kualifikuese e Evropianit të 2020-s.

1 000 mijë euro pagë mujore për familjen e Fadil Vokrrit

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Qeveria e Kosovës, pas propozimit të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, në mbledhjen e mbajtur të hënën e ka miratuar vendimin për njohjen e statutit të 'Qytetarit me Merita të Veçanta' për legjendën e futbollit të Kosovës, Fadil Vokri, për kontributin dhe promovimin e sportit. "Qeveria e Kosovës mori vendim për njohjen e statusit të qytetarit me merita të veçanta për Fadil Vokrin, për kontributin e tij që ka dhënë për promovimin e sportit. Në bazë të propozimit të bërë, në baza mujore familjes së tij do t'i ndahen mjete financiare në vlerë prej një mijë eurosh", ka thënë ministri Gashi, duke shtuar se "Fadil Vokri ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në futbollin e Kosovës qoftë si futbollist aktiv, mandej edhe si udhëheqës sportiv. Me angazhimin e tij kemi ardhur deri në këtë ditë, kur futbollit i Kosovës është i ndërkombëtarizuar plotësisht", ka shtuar ministri Gashi, i cili vendimin e



Qeverisë e vlerësoi si mirënjohje shtetërore. "Ky vendim është një vlerësim

dhe mirënjohje shtetërore për legjendën Vokri", ka përfunduar ministri Gashi.

Themelohet Federata e Triatlonit të Kosovës

PRISHTINË, 24 DHJETOR - Sportit të Kosovës i është shtuar edhe Federata e Triatlonit të Kosovës, e cila është themeluar në Kuvendin e mbajtur në sal-

lën e Shtëpisë së Sportit në Prishtinë. Në Kuvend janë zgjedhur organet drejtuese, të cilave do t'u prijë kryetari Vedat Tërmkolli. Pjesëmarrës

në Kuvend ishin 15 delegatë nga pesë klube të tri regjion-eve. Kuvendi u vëzhgua edhe nga Besire Domaniku, anëtare e Bordit Ekzekutiv të

Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Ibër Alaj, drejtor i Departamentit të Sportit në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport.



Adriano: Me Icardin do të ishim një dyshe e mrekullueshme

MILANO, 24 DHJETOR - Legjenda e Interit, Adriano, beson se do të ishin një dyshe fantastike me Mauro Icardin. 36-vjeçari iu bashkua klubit italian në vitin 2001 dhe me paraqitjet fantastike ishte një nga sulmuesit më të mirë në botë të kohës së tij por, për shkak të problemeve personale, shkëlqimi i karrierës së tij përfundoi para kohe. "E di sa i mirë isha dhe e di se kam bërë gjëra të rëndësishme. Nuk mund të besoja kur erdha fillimisht në Itali. Kujtoj se vetëm shikoja të gjithë përreth meje në bankën rezervë, nga [Clarence] Seedorf te [Marco] Materazzi. Gjithashtu kujtoj se Ronaldo më priti mirë, në shtëpinë e tij. Jetoja në hotel dhe ai më pyeti nëse dëshiroja të jetoja me atë. Ishte e bukur", ka thënë Adriano, duke shtuar: "Ne aspektin e sportit përjetova një provojë fantastike në zhveshtore, kurse në aspektin jetësor [Javier] Zanetti ishte shembull. Ai ishte gjithmonë përkrah meje, posaçërisht kur më vdiq babai, normalisht edhe presidenti [Massimo] Moratti më ndihmoi shumë, ai ishte si baba i dytë për mua. Do t'i jem mirënjohës përgjithmonë për të gjitha që bëri



për mua dhe familjen time në ato vite, sa herë që flas për atë emocionohem. Tani jam i lumtur me shokët dhe familjen time në Rio, jetojmë një jetë shumë normale. Nuk jam pensionuar, vetëm kam vendosur të bëj një pauzë". Adriano nuk e përjashton mundësinë e rikthimit në futboll. "Nëse ka një shans që të kthehem për të luajtur, do të jem aty, por vetëm në Brazil. Nuk mund të jem larg tre

